

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5764  
E hënë, 29 prill 2019  
çmimi 0.40 €

Në 20-vjetorin e rënies  
së Milazim Mavrajt  
kërkohet të mos ndahen  
dëshmorët | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", SOKOL BASHOTA | FAQE 4-5



## Do ta rikthejmë pushtetin në Klinë

Kryetari i rizgjedhur i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Klinë, Sokol Bashota, është shprehur i bindur se në zgjedhjet e ardhshme ky subjekt politik do të jetë numër një në vend. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Bashota ka thënë se vetëm me një qeveri të udhëhequr nga PDK-ja mund të kthehet besimi i qytetarëve në institucionet e vendit qoftë në nivelin lokal, qoftë në atë qendror. Ai nuk është shprehur i kënaqur me punën aktuale të koalicionit qeverisës në qendër, duke theksuar se qeveria aktuale lë shumë për të dëshiruar. Bashota ka treguar se tashmë i ka tejkaluar problemet me bashkëpartiakët të cilët e kishin sabotuar në zgjedhjet e fundit lokale

## Thaçi: Në Samitin e Berlinit të kërkohet njohja e Kosovës nga Serbia dhe pesë vendet e BE-së | FAQE 3

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se nikoqirët e Samitit të Berlinit, kancelarja Merkel dhe presidenti Macron, duhet ta kërkojnë njohjen e shtetit të Kosovës nga Serbia dhe pesë vendet e Bashkimit Evropian. Në një konferencë për medie të mbajtur të dielën para nisjes për në Berlin, presidenti Thaçi ka thënë se ky takim do të jetë një mundësi për hapjen e perspektivës më të shpejtë për të ardhmen evropiane të rajonit. Ai ka bërë me dije se Kosova në këtë samit shkon me qëndrime të qarta. Thaçi ka thënë se Kosova është e gatshme për vazhdimin e dialogut me Serbinë dhe për arritjen e marrëveshjes përfundimtare



**Nrekiqi:**  
Interesimi i  
shtetasve të  
Kosovës për  
të investuar  
në Ulqin  
asnjëherë nuk  
ka qenë më i  
madh | FAQE 9

### AKTUALE

**FILOZOFIA DHE  
ETIKA POLITIKE  
E UKSHIN HOTIT**

F. 11

Prof. ass. dr. Sabri  
KIÇMARI



**BEDRI HAMZA ZGJEDHET  
KRYETAR I PDK-SË NË  
MITROVICË** F. 6

**KOSNETT: S'MUND TË  
MOHohen KRIMET KUNDËR  
NJERËZIMIT NË KOSOVË** F. 7

### EKONOMI

**BIZNESET PRODHUESE  
NË KOSOVË LIROHEN NGA  
TATIMI DOGANOR DHE  
TATIMI I AKCIZËS** F. 8

**PAVARËSISHT PREJ  
INVESTIMEVE TË VOGLA,  
KOSOVA VEND ATRAKTIV  
PËR TURISTËT** F. 8

### EKONOMI

**BOTA E PËRTEJME E HARUKI  
MURAKAMIT** F. 16-17-18

### SPORT

**GARUESIT NGA KENIA  
TRIUMFOJNË NË  
GJYSMËMARATONËN  
'PRISHTINA 2019'** F. 20



**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

# Votat e shqiptarëve në fokus të kandidatëve presidencialë

Kandidatët për president të Maqedonisë së Veriut në rrethin e dytë, Stevo Pendarovski dhe Gordana Siljanovska Davkova, janë fokusuar në votën e qytetarëve shqiptarë dhe të atyre që bojkotuan zgjedhjet

SHKUP, 28 PRILL - Qytetarët shqiptarë dhe ata që bojkotuan zgjedhjet janë në fokus të dy kandidatëve për president, Stevo Pendarovski dhe Gordana Siljanovska Davkova. Kandidati i pushtetit, Pendarovski, në tentim për t'i bindur votuesit, gjatë fushatës për rrethin e dytë këmbëngul se koncepti i tij është ai euroatlantik që shpie vendin drejt BE-së. "Votimi për numrin 3 më 5 maj do të thotë se Gruevski asnjëherë më nuk do të kthehet në pushtet në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ndërsa do të kthehet ta mbajë dënimin me burgim në Idrizovë. Me votim masiv më 5 maj ne përfundimisht pas 10 vjetëve do të kemi president të shtetit në këtë shtet. Në tetë vjetët e para të mandatit të tij, Ivanovi ishte tërësisht i shurdhër për të gjitha devijimet që i bënte ai pushtet", u shpreh Stevo Pendarovski, kandidat për president.

Kandidatja e opozitës, Gordana Siljanovska, në fushatën e rrethit të dytë nuk e kritikon Ligjin për gjuhën shqipe e as nuk i shfaq si problematike për maqedonasit Marrëveshjen e Prespës dhe atë me Bullgarinë. Madje drejtpërdrejt kërkon edhe votën shqiptare, ka njoftuar "Alsat". "Si do të jetë nuk e di, por unë e di se kur u drejtohem qytetarëve, u drejtohem të gjithëve pa dallim të përkatësisë etnike, fetare dhe racore; u drejtohem të gjithëve si individë të respektuar me të drejtën e votës personale. Nëse do të fitoj, thellë do t'i falënderoj mbështetësit dhe do të deklaroj se partia ime do të jenë kushtetuta dhe ligjet, për shkak se unë jam njeri jopartiak", tha Gordana Siljanovska, kandidatë për presidente.

Ekspertët vlerësojnë se kandi-

datët për president dhe partitë që mbështesin ata morën mësim nga rrethi i parë i zgjedhjeve. Profetori universitar Qashif Bakiu thotë se ndryshimi i retorikës vjen pasi është e qartë që votat e shqiptarëve vendosin për fituesin e zgjedhjeve dhe për arritjen e censurit. "Ndryshimi i Pendarovskit vërehet në mënyrën e drejtpërdrejtë të komunikimit që bën ai me qytetarët. Ai e pa se nga distanca nuk mund të ofrohet, apo nuk mund ta sjellë efektin e duhur me qytetarët. Mendoj se ai ka ndryshuar qasjen duke tentuar që në mënyrë të drejtpërdrejtë të krijojë komunikim me votuesin shqiptar. E njëjta gjë vërehet edhe te Siljanovska, e cila tenton të zbusë raportin e fuqishëm nationalist që e bart



nga partia e cila i jep përkrahje asaj", theksoi Qashif Bakiu, profesor universitar. Ekspertët vlerësojnë se dy kan-



didatët në ditët e fundit të fushatës së rrethit të dytë do të bëjnë një fushatë intensive, me qëllim tërheqjen e sa më

shumë votuesve të cilët në rrethin e parë nuk e shfrytëzuan të drejtën e tyre për votë.

## Ahmeti e Mickoski, optimistë për pragun në rrethin e dytë

SHKUP, 28 PRILL - Kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti dhe kreu i VMRO-DPMNE-së opozitar, Hristjan Mickoski, besojnë se në rrethin e dytë të zgjedhjeve do të arrihet pragu prej 40 %. Ahmeti tha se fushata e partisë së tij për mbështetje të kandidatit të LSDM-së, Stevo Pendarovskit, nuk është e zbehtë dhe se BDI-ja do të angazhohet që t'i mobilizojë gjithë anëtarët e saj për të një fushatë dhe rezultat të suksesshëm nga zgjedhjet. "Unë e kam bërë një vlerësim dhe mendoj se kjo është një e arritur tani për tani më shumë e afërt. Organizimi është në nivel, të gjitha shtabet janë në krye të detyrës dhe besoj shumë që sukcesi do të jetë i plotë. Më 5 maj vendoset a do të jemi të suksesshëm dhe a do të japim porosi të komuniteti ndërkombehtar që ne jemi një shtet serioz,



mirë i organizuar sepse më 5 maj, në rrethin e dytë, nuk votohet thjesht kandidati, por votohet filozofia e përsheptimit të anëtarësimit të vendit tonë në NATO dhe në BE. Assesi nuk është zbehtë. Organet e partisë, të gjitha kanë mbajtur takime dhe kanë dhënë direktivat për mobilizim për 5 maj", tha Ali Ahmeti, kryetari i BDI-së.

Kryetari i VMRO-DPMNE-së, Hristjan Mickovski, beson se në rrethin e dytë do të arrihet pragu dhe qytetarët do ta zgjedhin presidentin. I pyetur nëse do të mbajë përgjegjësi nëse Gordana Siljanovska Davkova nuk do t'i fitojë zgjedhjet, Mickovski tha se pas zgjedhjeve do të bëhen analiza të rezultateve edhe pse, sipas tij, rrethi i parë dëshmoi se VMRO-DPMNE është parti e konsoliduar. Ditë më parë kreu i Aleancës për Shqiptarët, Ziadin Sela, tha se javën e ardhshme në kuvendin e partisë do të vendoset se si do të veprojnë më 5 maj. Megjithatë, Sela tha se është e drejtë e qytetarëve që të vendosin se si ata dëshirojnë dhe mohoi mundësinë për pazare politike në lidhje me mbështetjen e dy kandidatëve të mbetur për president, Gordana Siljanovska dhe Stevo Pendarovski.

## Zaevi paralajmëron zgjedhje të parakohshme parlamentare

SHKUP, 28 PRILL - Mediet kanë shkruar se kryeministri i Maqedonisë Veriore, Zoran Zaev, ka deklaruar që vendi mund të shkojë në zgjedhje të parakohshme parlamentare dhe këtë do ta përcaktojë rrethi

i dytë zgjedhor. Sipas tij, nëse nuk ndodh që të arrihet cenzusi, atëherë do të shpallen zgjedhjet parlamentare. Ai shprehet se në zgjedhje mund të shkohet edhe nëse nuk fiton kandidati Stevo Pendarovski.

"U rreshtuam pas një kandidati të pavarur për kryetar shteti për të cilin presim ta kurorëzojmë në këtë pozitë në Maqedoninë e Veriut. Unë besoj në këtë dhe kjo është dëshirë imja, përkushtimi im dhe pritshmëria ime

për shtetin e së ardhmes. Gjithsesi se për këtë vendosin qytetarët dhe nëse ata vendosin ndryshe, do të projektojmë një datë për zgjedhje të parakohshme parlamentare", tha kryeministri Zaev.



Sot (e hënë) do të mbahet Samiti i Berlinit, në të cilin do të marrin pjesë liderët e vendeve të Ballkanit Perëndimor, të ftuar nga kancelarja Merkel dhe presidenti Macron

# Thaçi: Në Samitin e Berlinit të kërkohet njohja e Kosovës nga Serbia dhe pesë vendet e BE-së



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se nikoqirët e Samitit të Berlinit, kancelarja Merkel dhe presidenti Macron, duhet ta kërkojnë njohjen e shtetit të Kosovës nga Serbia dhe pesë vendet e Bashkimit Evropian. Në një konferencë për medie të mbajtur të dielën para nisjes për në Berlin, presidenti Thaçi ka thënë se ky takim do të jetë një mundësi për hapjen e perspektivës më të shpejtë për të ardhmen evropiane të rajonit. Ai ka bërë me dije se Kosova në këtë samit shkon me qëndrime të qarta. Thaçi ka thënë se Kosova është e gatshme për vazhdimin e dialogut me Serbinë dhe për arritjen e marrëveshjes përfundimtare

**EPOKA E RE** **Shqipe HETEMI**

**PRISHTINË, 28 PRILL** - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka mbajtur një konferencë për medie të dielën para nisjes për në Gjermani, ku do të marrë pjesë në Samitin e Berlinit. Me këtë rast, ai ka thënë se ky takim do të jetë një mundësi e mirë për hapjen e perspektivës më të shpejtë për të ardhmen evropiane të rajonit. Thaçi ka bërë me dije se shteti i Kosovës në këtë samit shkon me qëndrime shumë të qarta.

Ai ka shprehur gatishmërinë e Kosovës për vazhdimin e dialogut me Serbinë dhe për arritjen e marrëveshjes përfundimtare, por ka përfunduar shkëmbimin e territoreve, sovranitetin e dyfishtë dhe çfarëdo asociacioni. "Nuk pres se aty do të ndodhë dialog në mes të Kosovës dhe Serbisë apo negociata, por në të njëjtën kohë vazhdoj ta ritheksoj fuqishëm pozicionin tim se do të

ishte me interes mbështetja e shqiptarëve të Luginës së Preshevës për bashkëngjitje me Republikën e Kosovës. Ky do të ishte një korigjim i padrejtësive historike, por gjithmonë do të jem kundër shkëmbimit të territoreve sepse është çështje e pazareve dhe nuk do të lejojmë një gjë të tillë të përdoret. Nuk do të lejojmë asnjë lloj sovraniteti të dyfishtë, as ndonjë model gjermano-gjerman, as ndonjë model të Republika Srpskës apo asnjë lloj asociacioni, sepse të gjitha janë tejkualuar", ka deklaruar Thaçi, duke shtuar se Kosova nuk do të pranojë dialog të kushtëzuar. "Gjithashtu, theksoj se edhe sa i përket mundësisë së vazhdimit të dialogut Kosova është shumë e qartë: është e gatshme ta vazhdojë dialogun me Serbinë për arritjen e një marrëveshje gjithëpërfshirëse. Një marrëveshje që ka perspektivë të sigurt për fqinjësi të mirë dhe njohje reciproke, por në asnjë rrethanë nuk do të lejojmë dialog

të kushtëzuar nga Serbia. Në këtë takim pres nga Merkel dhe Macroni që të dënohet gjenocidi që Serbia ka kryer në Kosovë, sepse në Berlin do ta kemi përballë një Serbi që ka kryer gjenocid në Kosovë", ka thënë Thaçi. Po ashtu, ai ka thënë se në Samitin e Berlinit pret që nikoqirët, kancelarja Merkel dhe presidenti Macron, ta kërkojnë njohjen e shtetit të Kosovës nga Serbia dhe pesë vendet e Bashkimit Evropian. "Ne do të vazhdojmë t'i rikonfirmojmë zotimet tona për reforma të nevojshme qoftë në ekonomi, qoftë në legjislacion apo kudo tjetër. Pres nga kancelarja Merkel dhe presidenti Macron që të kërkojnë nga presidenti Vuçiq njohjen e Kosovës në takim, por edhe njohjen e Kosovës nga pesë vendet e BE-së të cilat ende kanë hezitime për ta bërë një gjë të tillë. Do të jetë një mundësi e mirë që kancelarja Merkel dhe presidenti Macron ta bëjnë një gjë të tillë në një takim të rëndësishëm ku pritet janë të

mëdha, por nuk duhet pritur mrekulli", është shprehur presidenti.

Po ashtu, Thaçi ka shprehur optimizëm se kancelarja Merkel dhe presidenti Macron do të tregojnë mbështetje për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. Ai ka thënë se Kosova ka përmbushur të gjitha kriteret dhe e meriton lëvizjen e lirë si të gjithë qytetarët e tjerë të rajonit. Nëse diçka e tillë nuk ndodh, presidenti Thaçi ka vlerësuar se takimi i Berlinit do të jetë zhgënjyes për qytetarët e Kosovës. "Po ashtu, pres nga kancelarja Merkel dhe presidenti Macron të tregojnë mbështetje për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës si respektim i kontratës ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës. Kosova ka përmbushur të gjitha kriteret dhe e meriton lëvizjen e lirë si të gjithë qytetarët e tjerë të rajonit dhe kontinentit. Nëse diçka e tillë nuk ndodh, takimi i Berlinit do të jetë zhgënjyes për qytetarët e Kosovës", ka theksuar ai. BOX:

**Mustafa: Kosova ka nevojë për mbështetjen e Gjermanisë, të Francës, të Britanisë dhe të Amerikës për arritjen e marrëveshjes me Serbinë**

Ndërsa kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka deklaruar se Samiti i Berlinit është i rëndësishëm për ta dinamizuar procesin e bashkëpunimit të Bashkimit Evropian me vendet e Ballkanit Perëndimor. "Procesi i Berlinit, i ideuar nga kancelarja Merkel, ka shtyrë përpara rrjedhat e bashkëpunimit të BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe, po ashtu, ka krijuar rrethana të reja të komunikimit ndërmjet këtyre vendeve. Takimi i nesërm në Berlin është i dobishëm për të dinamizuar këtë proces. Jo vetëm Kosova dhe Serbia, por edhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor kanë shumë punë për t'u evropianizuar institucionalisht", ka shkruar Mustafa në llogarinë e vet në "Facebook".

Lideri opozitar ka vlerësuar se Kosova ka nevojë për përkrahje të Gjermanisë dhe të Francës, tani si vende boshte të BE-së për ta arritur marrëveshjen me Serbinë. "Sikurse që i nevojitet partneriteti i fortë me ShBA-në dhe Mbretërinë e Bashkuar për ta arritur marrëveshjen përfundimtare me Serbinë", është shprehur Mustafa, duke shtuar se LDK-ja nuk do të përkrahë asnjë marrëveshje e cila prek kufijtë e Kosovës dhe shtetësinë e shpallur më 17 shkurt 2008. "LDK-ja si parti më e madhe në vend, është shprehur qartë për nevojën e një marrëveshjeje të qëndrueshme, sikurse që ka qenë dhe është e qartë se nuk do ta përkrahë asnjë marrëveshje e cila prek kufijtë e Kosovës, shtetësinë e shpallur me Deklaratën e Pavarësisë të 17 shkurtit 2008, karakterin unitar të vendit dhe që është e rrezikshme për regionin dhe më gjerë. Kur Kosova është e qartë në qëndrime, e që mendoj se kështu është pjesa dërmuese e subjekteve, e ka më lehtë edhe në Berlin, edhe në Uashington, madje edhe miqve tanë ua lehtëson punën", ka deklaruar Mustafa.

Flet për "Epokën e re", Sokol Bashota

# Do ta rikthejmë pushtetin

Kryetari i rizgjedhur i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Klinë, Sokol Bashota, është shprehur i bindur se në zgjedhjet e ardhshme ky subjekt politik do të jetë numër një në vend. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Bashota ka thënë se vetëm me një qeveri të udhëhequr nga PDK-ja mund të kthehet besimi i qytetarëve në institucionet e vendit qoftë në nivelin lokal, qoftë në atë qendror. Ai nuk është shprehur i kënaqur me punën aktuale të koalicionit qeverisës në qendër, duke theksuar se qeveria aktuale lë shumë për të dëshiruar. Bashota ka treguar se tashmë i ka tejkalluar problemet me bashkëpartiakët e tij të cilët e kishin sabotuar në zgjedhjet e fundit lokale

**EPOKA  
ERE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 28 PRILL** - Ish-kryetari i Komunës së Klinës, Sokol Bashota, i cili sërish është zgjedhur në krye të Partisë Demokratike Kosovës (PDK) në Klinë, është shprehur i bindur se kjo parti do ta kthejë pushtetin në këtë komunë. Ai ka deklaruar se PDK-ja në zgjedhjet e ardhshme nacionale do të jetë parti e parë

në vend dhe do ta udhëheqë qeverinë.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai nuk është shprehur i kënaqur me punën aktuale të koalicionit qeverisës. "Mendoj se kjo është një qeverisje e cila lë shumë për të dëshiruar, sepse shumë projekte madhore për vendin nuk po ecin përpara. Shumë probleme në këtë qeveri janë si rezultat i kryeneçësisë dhe joprofesionalizmit të kësaj qev-

erie. Besoj se me udhëheqjen e qeverisë nga PDK-ja, e cila do të jetë fituese e zgjedhjeve të reja dhe me kryeministrin e ardhshëm që do të jetë nga PDK-ja, prapë do t'u kthehet qytetarëve besimi tek institucionet", ka thënë Bashota. Sipas tij, vetëm lidërshipi i kësaj partie mund t'i çojë përpara proceset e rëndësishme për Kosovën. "Besoj se tashmë qytetarët janë vetëdijësuar dhe sërish e kanë kthyer besimin te

lidërshipi i PDK-së sepse ai lidërshipi edhe në të kaluarën, në rrethana më të vështira për vendin, ka ditur t'i marrë përgjegjësit e veta dhe do të dijë edhe tani t'i marrë këto përgjegjësi dhe ta çojë përpara këtë vend", është shprehur Bashota. Ai e ka kritikuar qeverisjen në Komunën e Klinës, duke thënë se kjo qeverisje po u shërben vetëm interesave të ngushta klanore dhe jo qytetarëve. Sipas Bashotës, në

zgjedhjet e ardhshme lokale do të kthehet qeverisja e PDK-së në këtë komunë. "Synimin tonë për ta rikthyer pushtetin në Klinë po e ndihmon shumë një qeverisje e keqe, e cila është instaluar në Komunën e Klinës, pas një konglomerati të partive dhe njerëzve të cilët me shumë punojnë për interesa të ngushta individuale dhe klanore e aspak për qytetarët e Komunës së Klinës", ka deklaruar Bashota.

# në Klinë

transparent. Secili ka pasur të drejtë të zgjedhë dhe të zgjedhet. Gjatë këtij procesi në 42 nëndegë janë mbajtur kuvendet zgjedhore, ku 1 300 persona kanë marrë pjesë në këtë proces zgjedhor. Sa i përket asaj se si është pritur zgjedhja ime, mendoj se është pak herët të flasim, megjithatë sinjalet janë më të mira, ngaqë kam marrë shumë mesazhe urimi qoftë përmes rrjeteve sociale, qoftë sy me sy. Vetë fakti se rreth 85 për qind e 180 delegatëve më kanë votuar për kryetar, tregon se është mirëpritur zgjedhja ime kryetar dege në Klinë.

**"Epoka e re":** Në zgjedhjet e fundit lokale, për humbjen në garën për kryetar të Klinës, pate akuzuar shumë bashkëpartiake për sabotim. I keni eliminuar këto probleme brendapartiake?

**Bashota:** Mendoj se këto probleme janë eliminuar vetvetiu. Tashmë të gjithë janë të vetëdijshëm për gjithë atë proces të dhimbshëm. Besoj tashmë gjithçka është kthyer në binarë të duhur dhe të gjithë janë të bindur në fitoren e ardhshme të PDK-së jo vetëm në nivelin lokal, por edhe në atë qendror. PDK-ja në Klinë tanimë ka mbi 6 000 votues. Ky numër është arritur për herë të parë. Tani i bie se kemi më shumë vota se dy partitë e tjera më të mëdha në Klinë bashkërisht.

**"Epoka e re":** Sa besoni se me këto struktura të reja do ta riktheni qeverisjen e PDK-së në Klinë?

**Bashota:** Në këtë proces PDK-së i janë bashkangjitur shumë personalitete dhe intelektualë të profileve të ndryshme. Duke u bazuar në të gjithë atë vullnet të elektoratit të PDK-së që është parë në këto zgjedhje dhe gatishmërinë e të rinjve dhe të rejave që të marrin përgjegjësi, mendoj se kjo është garanci e madhe drejt fitores së radhës të PDK-së në Klinë. Të gjithë kanë hyrë me bindjen se PDK-ja ta rikthejë pushtetin në këtë qytetet.

**"Epoka e re":** Cili është vlerësimi juaj për qeverisjen në Klinë?

**Bashota:** Synimin tonë për ta rikthyer pushtetin në Klinë po e ndihmon shumë një qeverisje e keqe e cila është instaluar në Komunën e Klinës pas një konglomerati të partive dhe njerëzve të cilët me shumë punojnë për interesa të ngushta individuale dhe klanore e aspak për qytetarët e Komunës së Klinës. Mendoj se qytetari i Klinës nuk e meriton një qeverisje të tillë dhe një degradim

## Nehat Thaçi: Kosova ka burgjet më të mira në rajon

**PRISHTINË, 28 PRILL** - Burgjet në Kosovë po vlerësohen si më të mirat në rajon. Kështu ka thënë për "Ekonomia Online" drejtori i Shërbimit Korrektues të Kosovës, Nehat Thaçi. Ai është shprehur i bindur se në krahasim me burgjet e vendeve të rajonit, Kosova qëndron më mirë me kushtet që ofron për të burgosurit. "Gjendja dhe kushtet në burgjet e Kosovës konsideroj se janë mjaft të mira, të dënuarit kanë ankesa të ndryshme, mirëpo ne marrim parasysh disa situata kur shohim gjendjen në rajon, pra se si është gjendja e burgjeve në rajon dhe si është e jona, e marrim parasysh sigurinë për të burgosurit tanë, kushtet

higjienike, ushqimin që u ofrohet të burgosurve", ka thënë Thaçi.

Ai ka theksuar se janë marrë disa masa për t'i parandaluar dukuritë negative në burgjet e Kosovës, duke shtuar se ka pasur investime në skanerë dhe mjete të tjera për ta parandaluar kontrabandën në këto hapësira. "Është realiteti i hidhur kontrabanda në burgje, është fenomen botëror, nuk ka të bëjë vetëm me sistemin korrektues në Kosovë. Është e vërtetë se ka kontrabandë, e që kryesisht fillon nga telefonat dhe disa gjëra të tjera. Në vazhdimësi bëjmë bastisje të befasishme nëpër dhoma e qelitë e të burgosurve, gjithashtu bëjmë bastisje të

stafit tonë, të vizitorëve e të gjithëve", ka thënë Nehat Thaçi. Ai ka përmendur parandaluesin e valëve në burgun e Dubravës, investim ky i fundit që shërben për t'i parandaluar valët në telefon. "Në Burgun e Dubravës ne së fundi kemi instaluar parandalues të valëve që e bën të panevojshëm përdorimin e telefonave, mirëpo ky ndalues i valëve ndalon vetëm një pjesë të Burgut të Dubravës. Së fundi jemi në procedura prokurimi për t'i blerë edhe disa pajisje shtesë dhe vetvetiu me këto investime të sigurisë po provojmë të arrijmë parandalimin apo zvogëlimin e numrit të kontrabandës nëpër burgje tona", ka thënë Thaçi.



të pushtetit në këtë mënyrë. Jo vetëm për hir të elektoratit të PDK-së, por edhe për hir të të gjithë qytetarëve të Klinës duhet të rikthehet pushteti i PDK-së në këtë qytetet. Me qeverisjen tonë qytetari ka qenë në rend të parë. Tani besoj se edhe qytetarët e kanë kuptuar se vetëm me qeverisjen e PDK-së mund të kthehet besimi i qytetarëve në institucione.

**"Epoka e re":** Meqenëse po e vlerësoni si të dobët qeverisjen në këtë komunë që udhëhiqet nga AAK-ja, do të thotë kjo se qeveria qendrore e udhëhequr nga lideri i AAK-së nuk po e mbështet sa duhet?

**Bashota:** Në Klinë nuk është vetëm qeverisja e AAK-së. Aty është duke qeverisur një

konglomerat partish. Vetëm ne jemi në opozitë dhe një iniciativë qytetare që ka qenë aleate e jona në vitet e fundit. Nuk mund të them se është fajtores qeveria qendrore, por menaxhimi i keq në qeverisjen komunale. Këta nuk kanë aftësi as t'i zbatojnë projektet që ne i kemi aprovuar, ani pse buxheti për ato projekte ka qenë i ndarë.

**"Epoka e re":** Cili është vlerësimi juaj për qeverisjen në nivel qendror?

**Bashota:** Mendoj se kjo është një qeverisje e cila lë shumë për të dëshiruar, sepse shumë projekte madhore për vendin nuk po ecin përpara. Shumë probleme në këtë qeveri janë si rezultat i kryeneçësisë dhe joprofessionalizmit të kësaj qev-

erie. Besoj se me udhëheqjen e qeverisë nga PDK-ja, e cila do të jetë fituese e zgjedhjeve të reja dhe me kryeministrin e ardhshëm që do të jetë nga PDK-ja, prapë do t'u kthehet qytetarëve besimi tek institucionet. Në të kaluarën të gjitha projektet madhore që kanë qenë në interes të qytetarëve të vendit kanë pasur firmën e ish-kryeministrit Hashim Thaçi. Besoj se tashmë qytetarët janë vetëdijuesuar dhe sërish e kanë kthyer besimin të lidërsip i PDK-së, sepse ai lidërsip edhe në të kaluarën, në rrethana më të vështira për vendin, ka ditur t'i marrë përgjegjësit e veta dhe do të dijë edhe tani t'i marrë këto përgjegjësi dhe ta çojë përpara këtë vend.

**"Epoka e re":** Z. Bashota, jeni zgjedhur kryetar i Degës së PDK-së në Klinë. Si shkoj ky proces dhe si është pritur në elektorat zgjedhja juaj?

**Bashota:** Pas vendimit të Kryesisë Qendrore të PDK-së për t'i organizuar zgjedhjet e brendshme, edhe Dega në Klinë, në përputhje të rregullores së brendshme për zgjedhjet, ka filluar këtë proces. Procesi zgjedhor në Degën e PDK-së në Klinë ka qenë mjaft

## Bedri Hamza zgjedhet kryetar i PDK-së në Mitrovicë

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka mbajtur kuvendet zgjedhore në Degën e Mitrovicës, Ferizajt dhe Klinës. Bedri Hamza është zgjedhur kryetar dege në Mitrovicë, Agim Aliu në Ferizaj dhe Sokol Bashota në Klinë



**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

**MITROVICË, 28 PRILL** - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka mbajtur të dielën Kuvendin Zgjedhor në Degën e Mitrovicës, ku me shumicë votash kryetar i degës është zgjedhur Bedri Hamza, i cili mban edhe pozitën e ministrit të Financave në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

210 delegatët e Kuvendit Zgjedhor në Mitrovicë kanë zgjedhur Këshillin Drejtues prej 71 anëtarëve dhe 21 delegatë për Konventën Qendrore. Në emër të kryetarit të PDK-së, Kadri Veseli, Kuvendin Zgjedhor e kanë përshëndetur shefi i Grupit Parlamentar i PDK-së, Memli Krasniqi, si dhe ministrja Dhurata Hoxha.

Krasniqi vuri në dukje angazhimin e gjithanshëm të strukturave për

zgjedhjet e brendshme, proces i cili rikonfirmon fuqinë e jashtëzakonshme të anëtarësisë së gjerë të PDK-së. "Dekada e Re' është platformë e cila u siguron qytetarëve të vendit besim, zhvillim dhe integritet, në veçanti rinisë dhe grave, duke e bërë këtë proces të jashtëzakonshëm, ashtu siç i ka hije PDK-së dhe vizionit të përqafuar nga qytetarët e vendit", ka thënë Krasniqi, duke shtuar se zgjedhjet e

brendshme riafirmuan potencialin politik dhe krijues të PDK-së si parti e së tashmes dhe të ardhmes. Dhurata Hoxha ka vlerësuar se "Mitrovica merr vëmendjen më të madhe se zgjedhjet në degët e tjera në vend, duke qenë degë e liderit tonë, Kadri Veselit dhe udhëheqësve të dëshmuar në nivel nacional. Këto zgjedhje janë shtytje e re për organizim edhe më të mirë, gjithëpërfshirje dhe vlera me

besim, zhvillim dhe integritet", ka thënë ajo.

Në emër të Komisionit Lokal Zgjedhor, para qindra delegatëve të pranishëm kanë folur Arian Tahiri dhe Drita Kadriu, të cilët kanë konfirmuar se në secilën nëndegë të Mitrovicës PDK-ja ka zgjedhur qytetarët më të mirë të lagjeve të cilët do të punojnë ngushtë për ta forcuar edhe më shumë Partinë Demokratike të

Kosovës.

Partia Demokratike e Kosovës ka mbajtur kuvendet zgjedhore edhe në degët e komunave në Ferizaj dhe Klinë. Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka marrë mbështetjen e plotë të delegatëve për ta udhëhequr degën e PDK-së në këtë komunë. Po ashtu, Sokol Bashota është zgjedhur me unanimitet të plotë kryetar i Degës së PDK-së në Klinë.

## Përfundon pjesa e parë e programit të shkëmbimit të nxënësve në mes të Kosovës dhe Shqipërisë 'Si n'shpin tënde'

**EPOKA E RE** **Qendresa RAMA**

**PRISHTINË, 28 PRILL** - Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT), në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), organizuan ceremoninë e përshëndetjes mes nxënësve të shkëmbyer gjatë këtyre dy javëve në mes të Kosovës dhe Shqipërisë si pjesë e programit të shkëmbimit të nxënësve mes dy vendeve.

Programi, i cili është quajtur "Si n'shpin tënde", që ka për qëllim integrimin e nxënësve në sistemin arsimor të vendit pritës dhe krijimin e thellimit dhe miqësisë, do të vazhdojë me grupe të tjera të nxënësve, ndërsa po shikohen mundësitë për qëndrim më të gjatë të nxënësve, ndoshta edhe deri në një gjysëmjetor. Zëvendësministri i Arsimit, Hestet Sahiti, me këtë rast ka thënë se iniciativa e shkëmbimit të nxënësve në mes të Kosovës dhe



Shqipërisë, tashmë e realizuar me sukses, është inkurajuese për të vazhduar edhe në vitet e tjera, pasi të rinjtë dhe vetë ne kemi nevojë të kemi më shumë lidhje vëllazërore. "Ka ardhur koha që nxënësit tanë nga Mitrovica, Saranda, Kamenica, Shkodra, nga Prishtina e Tirana, të njihen, të

bashkëpunojnë dhe t'i shkëmbejnë përvojat, idetë, synimet dhe qëllimet e tyre", ka thënë zëvendësministri Sahiti. Ministrja e Arsimit e Shqipërisë, Besa Shahini, ka thënë se qëllimi i programit është që ta njohim sa më mirë dhe ta duam sa më shumë njëri-tjetrin.

"Paragjykimet nuk do të ndodhin nëse ne e njohim më mirë njëri-tjetrin dhe thellohem në mënyrën e jetesës së njëri-tjetrit. Jemi dy vende shqipfolëse, kështu që e kemi të domosdoshëm bashkëpunimin", u shpreh ministrja.

Ndërsa nxënësit që ishin pjesë e

këtij programi theksuan se janë të kënaqur që u është dhënë kjo mundësi për ta përjetuar këtë përvojë të mirë dhe për të krijuar miqësi mes vete.

Për këtë, nxënësit kanë falënderuar ministrinë e Arsimit të të dyja vendeve që e filluan këtë program. Edhe familjet pritëse dhe drejtorët e shkollave dhe drejtorive komunale të arsimit të qyteteve të ndryshme theksuan rëndësinë e këtij programi dhe u shprehën të lumtur për mundësinë që iu është dhënë fëmijëve.

Gjatë qëndrimit të Kosovë nxënësit nga Shqipëria, bashkë me moshatarët e tyre kanë vizituar edhe vende kulturore dhe historike. Programi për shkëmbimin e nxënësve ka filluar me marrëveshjen paraprake në mes të ministrave të Arsimit të Kosovës dhe Shqipërisë, Shyqiri Bytyqi dhe Besa Shahini, dhe do të vazhdojë me grupe të tjera të nxënësve. Në fund, të gjithë nxënësve pjesëmarrës në program u janë ndarë certifikata pjesëmarrje dhe mirënjohje.

# Në 20-vjetorin e rënies së Milazim Mavrajt kërkohet të mos ndahen dëshmorët

Me rastin e 20-vjetorit të rënies së dëshmorit Milazim Mavraj, ministri i Mbrojtjes, Rustem Berisha, dhe kryetari i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve, Xhavit Jashari, kanë bërë thirrje që mos të ndahen dhe selektohen dëshmorët se në cilën brigadë apo zonë kanë luftuar. Ministri Berisha ka theksuar se Kosharja është identifikuar si simbol i bashkimit. "Nëse të tjerët e pranojnë suksesin e Milazimit dhe shumë dëshmorëve të tjerë, atëherë cila është arsyeja që ne të përçahemi", ka thënë Rustem Berisha



EPOKA  
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

**BURIM, 28 PRILL** - Në qendër të Komunës së Burimit, pranë bustit të dëshmorit të kombit Milazim (Sadri) Mavraj, i njohur me nofkën "Çeçeni", i cili ka rënë heroikisht në rrasë të Koshares para 20 vjetësh, të dielën është mbajtur një akademi përkujtimore, në të cilën kanë qenë të pranishëm përfaqësues të institucioneve të vendit, përfaqësues të organizatave të dala nga lufta, qytetarë dhe familjarë të dëshmorit Milazim Mavraj. Ministri i Mbrojtjes i Kosovës, Rustem Berisha, dhe kryetari i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve, Xhavit Jashari, kanë bërë thirrje që mos të ndahen dhe selektohen dëshmorët se në cilën brigadë apo zonë kanë luftuar. Ministri Berisha në emër të kryeministrit Ramush Haradinaj ka përhëndetur të pranishmit në këtë akademi përkujtimore, ku më pas ka folur për veprimtarinë e dëshmorit Milazim Mavraj. "Më lejoni që në emër të kryeministrit Haradinaj t'ju përhëndes dhe t'ju përgëzoj për organizimin

e këtij manifestimi kushtuar heroit Milazim Mavraj - 'Çeçeni' dhe të gjithë atyre që kanë marrë pjesë në betejën e Koshares. Është hera e parë që ju drejtohem si ministër i Mbrojtjes, pasi ka kaluar një kohë e gjatë që shteti i Kosovës nuk ka pasur ushtrinë e vet, por që nga 21 janari i këtij viti Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës është shndërruar në Ministri të Mbrojtjes dhe që tani e ka mandatin e ri ushtarak. Kur jemi te heroit që e përkujtojmë sot, Milazimi, ai ishte pjesë e Koshares, përkatësisht Brigadës 138 'Agim Ramadan'. Brigadës që me luftë e hoqi kufirin shqiptaro-shqiptar, brigadë e cila ka disa të veçanta që në vazhdimësi do t'i kujtojmë. E veçanta e kësaj brigade ishte që në strukturën e saj kanë qenë djem dhe vajza nga të gjitha pjesët e Kosovës dhe jashtë saj, gjithashtu edhe nga diaspora", ka thënë Berisha, duke shtuar se Kosharja është identifikuar si simbol i bashkimit. Ai ka apeluar që mos të ketë debate përçarëse sa i përket pjesëmarrjes së ushtarëve të UÇK-së nëpër brigada të ndryshme. "Pavarësisht prej

debateve që po mundohen t'i japin kahe, nuk kemi ndonjë peshore që t'ua masim kontributin asnjërit prej pjesëmarrësve, pra është mirë që secili ta ketë nivelin e vet dhe askush mos të mundohet ta zbehë betejën e Koshares. Po mos të ishim të bashkuar, as Kosharja nuk do ta kishte suksesin që pati. Nëse të tjerët e pranojnë suksesin e Milazimit dhe shumë dëshmorëve të tjerë, atëherë cila është arsyeja që ne të përçahemi", ka deklaruar Berisha. Sipas tij, beteja e Koshares ishte një ndër faktorët e nënshkrimit të kapitullimit të Sllobodan Milloshoviçit. "Pavarësisht prej politikës ditore, duhet të jemi bashkë dhe të mos lejojmë që dikush t'i japë kahe ndryshe betejës së Koshares. Një element tjetër që dëshiroj ta theksoj, dhe që në të ardhmen edhe historia do të japë kontribut në shënimin e së vërtetës, një nga faktorët që detyroi Milloshoviçin ta nënshkruajë kapitullimin, ishte

edhe beteja e Koshares. Të jeni të bindur për këtë. Ende nuk është diskutuar për këtë, por në të ardhmen edhe ky element do të dalë. Secili luftëtar është histori në vete dhe le të flasë për ndodhitë që vetë i ka përjetuar dhe nuk ka nevojë të flasë për çështjet që nuk ka marrë pjesë. Ju ftoj të bashkohemi dhe ta realizojmë amanetin e heroit tonë. Lavdi e përjetshme jetës dhe veprës së heroit tonë Milazim Mavraj - 'Çeçeni' dhe të gjithë atyre që dhanë jetën për këtë vend!", ka thënë ministri Berisha, raporton "Epoka e re". Ndërsa kryetari i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve, Xhavit Jashari, ka bërë thirrje që mos të ketë ndarje të dëshmorëve. Ai ka thënë se dëshmorët nuk iu përkasin partive politike. "Mua nuk ma lejon as detyra dhe as përfaqësimi që t'i ndaj dhe t'i pjesëtoj dëshmorët. E them këtë për faktin se sot po shoh shumë familjarë të dëshmorëve që kanë rënë në Koshare dhe që janë të komunave

të ndryshme të Kosovës. Më mirë se unë dhe secili nga ne flasin vetë dëshmorët që kanë marrë pjesë në luftën e Koshares. Këtë muaj kemi shumë manifestime të rënies së dëshmorëve. Të gjithë dëshmorët para nesh dhe kujtesës historike janë të barabartë. Kosharja sa është e Agimit, Abazit, është edhe e dëshmorëve të tjerë që kanë rënë nga hapësirat e gjeografisë shqiptare. Ne duhet të ecim në rrugën që na kanë lënë dëshmorët dhe nuk duhet të merremi me vetveten. Mos të themi se ata që kanë luftuar në këtë krahinë janë dëshmorë të kësaj krahine", ka thënë Xhavit Jashari. Ai ka kërkuar nga institucionet e vendit që të përkujdesen për dëshmorët dhe familjet e tyre. "Ata kanë rënë që ne sot lirshëm të punojmë për rrugën e tyre. U bëjmë thirrje institucioneve që dëshmorët t'i përkujtojnë me punë konkrete, duke u ngrehur lapidarë dhe ta shkruajnë historinë reale", ka thënë Jashari.

## Kosnett: S'mund të mohohen krimet kundër njerëzimit në Kosovë

**GIJAKOVË, 28 PRILL** - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Prishtinë, Philip Kosnett, i cili mori pjesë në shënimin e 20-vjetorit të masakrës së Mejës, ka thënë se mohimi i ngjarjeve të tilla "ua rihap plagët të gjallëve dhe e kthen rajonin prapa". "E dimë se ka njerëz që do ta mohonin realitetin e dokumentuar mirë të mizorive të kryera në Mejë dhe vendet e tjera në Kosovë. Mohimi i këtyre ngjarjeve përdhos kujtimin e të vdekurve, ua rihap plagët të gjallëve dhe e kthen rajonin prapa në përpjekjet për të ndërtuar shtete demokratike në paqe me njëri-tjetrin. Pranimi i krimeve kundër njerëzimit të kryera këtu dhe në pjesë të tjera të këtij vendi është jetik për të siguruar që ato të mos përsëriten kurrë më", ka thënë ambasadori Kosnett, duke shtuar se ShBA-ja veproi në Kosovë në mbështetje të civilëve të pambrojtur.

Ambasadori Kosnett ka thënë se askush nuk duhet të dyshojë "sa e thellë apo e qëndrueshme është miqësia mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kosovës". "Mbështetja e Amerikës ndaj qëllimit për paqe, drejtësi dhe mbarësi për Kosovën dhe fqinjët e saj mbetet e qëndrueshme. Përkushtimi i Amerikës për të ardhmen e Kosovës paraqet një trashëgimi të thellë për ata që vdiqën që Kosova të jetë e lirë", ka thënë Kosnett. Në Mejë, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se qytetarët e Kosovës kërkojnë drejtësi për krimet e kryera dhe për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur. Ndërkaq kryeparlamentari Kadri Veseli ka thënë se Kosova nuk do të ndalet së kërkimi drejtësi për masakrat e kryera. Në fjalën e tij, kryeministri Ramush Haradinaj, pikërisht në



Ditën e të Pagjeturve, ka thënë se përmes Ligjit për personat e zhdukur, i cili është ende në diskutim publik, do të rregullohet

statusi i personave të zhdukur dhe martirëve. Më 27 prill 1999 në Mejë të Gjakovës u vranë 367 persona. Që

prej përfundimit të luftës në Kosovë, ende konsiderohen të pagjetur mbi 1 600 persona, shumica prej të cilëve janë shqiptarë.

# Bizneset prodhuese në Kosovë lirohen nga tatimi doganor dhe tatimi i akcizës

PRISHTINË, 28 PRILL (ER) - Ministria e Financave nga fillimi i vitit 2018 në çdo tre muaj të vitit ka marrë vendim për lirim nga tatimi doganor dhe tatimi i akcizës për bizneset prodhuese në Kosovë. Këto lirime kanë të bëjnë me lëndën e parë, gjysmëproduktet, linjat e prodhimit, pajisjet e TI-së, lëndët ndihmëse të cilat marrin pjesë në procesin e prodhimit dhe pjesët rezervë për linjat e prodhimit.

Më pas janë marrë një varg reformash fiskale në Tatimin e Vlerës së Shtuar, ku përmes Ligjit i cili është në Kuvendin e Kosovës do të lirohen nga Tatimi i Vlerës së Shtuar lënda e parë që prodhohet në vendin tonë për prodhues, do të thjeshtëzohen procedurat e kthimit të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar dhe çka është më thelbësorja që ndodh për herë të parë në vendet e rajonit tonë, fillimi i mbledhjes së TVSh-së nga kufiri në import në brendi të vendit.

Sipas një komunikate të Ministrisë së Financave, theksohet se ministri Bedri Hamza gjithmonë e ka potencuar se bartës i zhvillimit ekonomik në Kosovë duhet të jetë sektori privat dhe mbi bazën e këtij parimi edhe më 26 prill në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës ministri Hamza ka vazhduar me kërkesën për lirim nga tatimi doganor për shtazët të cilat importohen në vendin tonë. "Gjatë analizave tona në Ministri të Financave kemi konstatuar se edhe në sektorin e bujqësisë, përkatësisht te blegtoria, importimi i kafshëve duhet liruar nga tatimi doganor me qëllim që t'u mundësohet të gjithë qytetarëve dhe fermerëve që me kosto sa më të ulët të kenë mundësi të importojnë kafshë në vendin tonë me qëllim të zgjerimit të kapaciteteve të tyre prodhuese", është thënë në komunikatën e kësaj ministrie.

Po ashtu, ministri Hamza në



këtë mbledhje e ka informuar qeverinë se, përveç lirimt nga tatimi doganor të kafshëve për disa kategori që e lejon Ligji i Tatimit mbi Vlerën e Shtuar në fuqi, do të marrë vendim për ta ulur Tatimin e Vlerës së Shtuar

nga shkalla 18 për qind sa është sot, në shkallën e ulët 8 për qind, prapë me të vetmin qëllim, që t'i ndihmojë qytetarët dhe fermerët që të importojnë kafshë në vendin tonë me kosto sa më të ulët.

Ministri Hamza ka theksuar edhe një herë se nuk do të ketë rritje të tatimeve ekzistuese dhe nuk do të ketë tatime të reja për qytetarët dhe bizneset në Kosovë, por do të ketë lirime dhe thjeshtëzim të procedurave.

## Pavarësisht prej investimeve të vogla, Kosova vend atraktiv për turistët



PRISHTINË, 28 PRILL - Kosova vazhdon të mbetet vend atraktiv për turistët. Vetëm gjatë vitit të kaluar, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe Doganës, janë shënuar më shumë se 700 mijë vizita, me 138 nacionalitete të ndryshme që kanë hyrë në Kosovë. Turizmi malor vazhdon të jetë më atraktiv. Kosova ka një sipërfaqe prej më

shumë se 10 mijë kilometrash katrorë dhe ka rreth një mijë vende të cilat konsiderohen atraktive për t'u vizituar dhe zhvilluar turizmin. Ndonëse janë shënuar rritje vizitash, Kosova mbetet ende vendi i fundit në rajon sa iu përket investimeve në sektorin e turizmit ku, sipas profesionistëve të kësaj fushe, thuhet se më pak se 100 mijë euro investohen

brenda vitit për këtë sektor, derisa vendet e rajonit, sipas tyre, shpenzojnë miliona euro për turizmin.

Dren Zatriqi, ekspert i turizmit, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se numri më i madh i turistëve që vizitojnë Kosovën janë nga Evropa Qendrore apo gjermano-folësit si dhe nga grupet e Azisë e që janë pjesë të grupeve ballkanike, ku edhe

Kosova po hyn në këtë grup. "Edhe këtë vit presim trend të rritjes së turistëve. Kryesisht turistët vijnë nga Evropa Qendrore, Azia, por edhe nga vendet e Ballkanit. Kosova është bërë atraktive, sidomos për këtë grup të turistëve. Për turizëm jemi vend me buxhetin më të ulët në rajon, pra rreth 100 mijë euro investohen nga shteti në vit për turizëm, derisa

vendet e tjera kanë miliona euro investime. Ne kemi nevojë për përmirësim të shërbimeve dhe atraksioneve për dallim me shtetet në rajon", ka vlerësuar Zatriqi.

Turistët në Kosovë i përcjellin ciceronët vendorë. Tashmë çdo qytet i ka të ndarë ata, varësisht nga gjuha që flasin, për t'u përshtatur dhe kuptuar me turistët.



# Nrekiqi: Interesimi i shtetasve të Kosovës për të investuar në Ulqin asnjëherë nuk ka qenë më i madh

Kryetari i Komunës së Ulqinit, Loro Nrekiq, ka thënë se interesimi i afaristëve nga Kosova për të investuar në Ulqin, në sektorin e hotelierisë dhe ndërtimit, është i lartë madje, sipas tij, interesimi nuk ka qenë asnjëherë më i madh. Sa iu përket polisave të sigurimit, respektivisht Kartonit të Gjellbër, ai ka apeluar që të hiqet sa më parë, për të cilën gjë ka kërkuar edhe mbështetjen e të dy qeverive



**EPOKA  
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 28 PRILL - Kryetari i Komunës së Ulqinit, Loro Nrekiq, që vjen nga radhët e Partisë Demokratike të Socialistëve (DPS), ka thënë se interesimi i afaristëve nga Kosova për të investuar në Ulqin, në sektorin e hotelierisë dhe ndërtimit, është i lartë madje, sipas tij, interesimi nuk ka qenë asnjëherë më i madh. "Sa iu përket bizneseve nga Kosova, ka interesim të madh për të investuar në Ulqin, sidomos ky interesim ka ardhur në vitet e fundit. Shumë qytetarë të Kosovës po investojnë në Komunën e Ulqinit, në hotele, restorante dhe objekte ndërtimore. Interesimi kurrë nuk ka qenë më i madh se tani. Është shumë më mirë të vijë qytetarët e Kosovës të investojnë në Ulqin sesa dikush tjetër. Ulqini është i etshëm për investime", ka thënë Nrekiqi për gazetën "Epoka e re".

Ai ka thënë se janë duke inves-

tuar në projekte milionëshe në infrastrukturë dhe në parkingje. "Pa zhvillimin e infrastrukturës nuk ka zhvillim, andaj ne kemi investuar pesë milionë euro për kanalizimin e katër lagjeve dhe çështjes ekologjike. Po ashtu, 20 milionë euro për investimin e ujësjellësit në tërë qytetin. Kemi ujësjellësin regional, por që 40 vjet nuk kishte investime. Ajo që vlen të theksohet është se do të investojmë edhe në parkingje. Tani jemi duke i bërë sinjalizimet për vendet e parkingut në mënyrë që turistëve t'u sigurojmë parking të mjaftueshëm dhe mos të kenë telashe sikur më parë", u shpreh Nrekiqi. Sa iu përket polisave të sigurimit, respektivisht Kartonit të Gjellbër, ai ka apeluar që të hiqet sa më parë, për të cilën gjë ka kërkuar edhe mbështetjen e të dy qeverive. "Kartoni jeshil është problem për të dy qeveritë dhe qytetarët e të dyja vendeve. Qeveria e Malit të Zi është më e vullnetshme sesa e Kosovës për ta zgjidhur këtë problem. Meqenëse të dy

qeveritë kanë raporte të mira miqësore, kjo çështje duhet të zgjidhet në nivel qeverish. Ka qenë një takim para disa muajsh, ku kam biseduar me kryeministrin e Malit të Zi për këtë çështje. Edhe pse na dukën shuma të vogla, janë shumë të mëdha si për vizitorët në Ulqin, po ashtu edhe për ne. Kartoni i Gjellbër duhet të hiqet sa më

parë dhe do të bëjë çmos si në ministri ashtu dhe te presidenti i shtetit që të hiqet sa më parë dhe të evitohen disa barriera ligjore", u shpreh ai. Ai ka folur edhe për çmimin e çadrave ne plazhet e Ulqinit, për të cilën ka vërejtje se është i lartë. "Çmimi i çadrave është çështja e pronarëve të plazheve. Ne nuk mund të bëjmë diçka

pasi kjo është çështje e pronarëve dhe ata paguajnë tatim deri në 41 000 euro, 50 000, 60 000 euro përgjatë sezonit. Pra, janë çmime në bazë të të cilëve duhet të fitojnë edhe pronarët. Duhet të bëhet një lloj balancimi me çmimin e të mirave detare", ka thënë kryetari i Komunës së Ulqinit, Loro Nrekiq.

## Ministri Reçica merr përkrahje nga Departamenti Amerikan i Shtetit

PRISHTINË, 28 PRILL (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, javën e kaluar ishte në vizitë zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), ku zhvilloi disa takime të rëndësishme. Ministri u prit në takim në Departamentin Amerikan të Shtetit. I shoqëruar nga ambasadorja e Kosovës në ShBA, Vlora Çitaku, ministri Reçica u takua me Paul Pfeuffer nga Zyra për Çështje të Evropës Qendrore dhe Jugore.

Në takim u diskutua për sfidat me të cilat ballafaqohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, sidomos rreth papunësisë dhe shërbimeve familjare dhe sociale. Në takim u diskutuan dhe u vlerësuan veprimet rreth reformave të ndërmara nga MPMS-ja, përmblyjes së infrastrukturës ligjore dhe fillimit të zbatimit të tyre, si dhe për-

bushjes së obligimeve të MSA-së. Gjithashtu, mes bashkëbiseduesve u fol edhe për zhvillimet politike në Kosovë. Gjatë qëndrimit në ShBA, ministri Reçica zhvilloi edhe një takim me Kevin Willcutts nga Departamenti Shtetëror i Punës. Temë diskutimi ishte puna e rëndë e fëmijëve, posaçërisht format e këqija të punëve të fëmijëve, me ç'rast ministri tregoi rreth sfidave me të cilat Kosova përballlet në këto fusha. Nga Departamenti Shtetëror i Punës u zotuan për ta mbështetur Kosovën nëpërmjet formave të bashkëpunimit, si: trajnime për Inspektoratin e Punës, për qendrat për punë sociale, policinë dhe organet e tjera, me qëllim të parandalimit dhe të trajtimit të duhur të punëve të rënda të fëmijët si dhe ato rreth trafikimit.





## Komandant Ilaz Kodrës i ngrehet një shtatore

SKENDERAJ, 28 PRILL (ER) - Me rastin e shënimit të 20-vjetorit të rënies heroike të komandantit Ilaz Kodra, 40 dëshmorëve dhe 275 martirëve të lirisë, Komuna e Skenderajt

dhe ajo e Drenasit do ta organizojnë manifestimin përkujtimor. Me këtë rast, do të bëhet edhe zbulimi i shtatores së Ilaz Kodrës në Drenas. Aktivitetet do të mbahen më

30 prill, që do të nisin me homazhe në Kompleksin Përkujtimor "Adem Jashari" në Prekaz dhe do të përfundojnë me zbulimin e shtatores së Ilaz Kodrës në Drenas.

## Komuna e Gjilanit, krenare me nivelin e nxehësve në fushën e matematikës

GJILAN, 28 PRILL (ER) - Në Komunën e Gjilanit kanë nisur të mbahen garat komunale në lëndën e matematikës. Në këtë drejtim Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme. Kësaj gare janë duke iu nënshtruar nxënësit nga të gjitha shkollat e Gjilanit nga klasat e pesta e deri në të teta.

Dekani i Shkencave Kompjuterike në Universitetin "Kadri Zeka", Xhevdet Thaçi, ka thënë se niveli kaq i lartë pjesëmarrjes së nxënësve në këto gara u jep energji shtesë që të punojmë edhe më shumë në këtë drejtim. "Ata të cilët merren me mësimin e mëvonë edhe studimin e matematikës, gjithmonë do të jenë në planin e parë. Me orientim në këtë drejtim do të thotë se në jemi konkurrentë të shteteve të zhvilluara dhe konkurrentë të përbashkët në të gjitha fushat, sepse me matematikë dhe me këtë përkushtim të nxënësve, prindërve dhe mësimit nxënësve,

sigurisht se gjithmonë do të kemi suksese. Universiteti 'Kadri Zeka' është i nderuar dhe po punon që të krijojë hapësirë edhe për shkencat natyrore, konkretisht matematikës", ka thënë Thaçi.

Ndërsa drejtori i Arsimit në Gjilan, Nazim Gagica, ka falënderuar të gjithë nxënësit për angazhimin maksimal që po japin në mënyrë që Gjilani ta ketë epitetin e qytetit lider në fushën e matematikës dhe qytetit të shkencës në përgjithësi. "Komuna e Gjilanit është krenare me nivelin që kanë nxënësit në shkollave në të gjitha lëndët e veçanërisht në lëndën e matematikës dhe gjithmonë jemi përkrahës institucionalë, sikur që ju jeni përkrahësit e Gjilanit në rrafshin e dijes", ka thënë Gagica. Ndërsa kryetari i Shoqatës "Paskal", Agim Buklla, që edhe është në këshillin organizativ të garave, ka falënderuar Komunën e Gjilanit dhe kryetarin Lutfi Haziri për mbështetjen e dhënë në organizim të garave në këtë komunë.



## Në shkollën 'Sylë Alaj' në Drenoc mbillen fidanë në kuadër të 'Javës së Tokës'



DEÇAN, 28 PRILL (ER) - Gjelbërimit të bukur brenda hapësirave të ShFMU "Sylë Alaj" në Drenoc të Deçanit i janë shtuar edhe dhjetëra fidanë të cilët janë mbjellë bashkë me drejtorin, mësimit nxënësit dhe nxënësit e kësaj shkolle. Përveç mbjelljes së këtyre fidanëve, nxënësit e kësaj shkolle kanë zhvilluar edhe një aksion pastrimi brenda dhe jashtë hapësirave të kësaj shkolle.

Me nismën e organizatës "Ta pastrojmë Kosovën", nxënësve dhe vullnetarëve të tjerë i është bashkuar edhe kryetari i fshatit të Drenocit dhe përfaqësuesi i ndërmarrjes "Higjiena". Fidanët e mbjellë kanë qenë dhuratë nga fidanishtja e dru-

frutorëve "Diamanti" në Drenoc. Me këtë rast, Komuna e Deçanit ka falënderuar pronarin e kësaj fidanishteje, i cili, po ashtu, ishte i pranishëm në këtë aksion. "Po ashtu, falënderojmë edhe 'Swiss Marketing Group' për ndihmën dhe organizimin e këtij aktiviteti. Urojmë që shembulli i kësaj shkolle për përkujdesjen e shtimit të hapësirave të gjelbra dhe mirëmbajtjen e hapësirave brenda dhe jashtë shkollës të ndiqet edhe nga shkolla të tjera. Nisma të tilla është mirë të ndjekin edhe shkollat e tjera. Çdo ditë të kujdesemi për ambientin tonë", është bërë me dije në njoftimin e Komunës së Deçanit.

## Malisheva përfiton 25 kontejnerë në kuadër të fushatës "Ta pastrojmë Kosovën"

MALISHEVË, 28 PRILL (ER) - Në kuadër të aksionit "Ta pastrojmë Kosovën", i cili është zhvilluar nga 15 shtatori dhe ka zgjatur deri më 15 dhjetor të vitit të kaluar,

ndër komunat që kanë treguar rezultate të mira në këtë aksion është edhe Komuna e Malishevës, e cila nga ky projekt ka përfituar 25 kontejnerë dhe 25 shpor-

ta për grumbullimin e mbeturinave. Kjo është konfirmuar nga koordinatoresha e këtij aksioni për Komunën e Malishevës, Saranda Dobruna, dhe koordinatori

komunal Naser Morina, të cilët kanë qenë personat e autorizuar për zhvillimin dhe koordinimin e këtij aksioni në Komunën e Malishevës.







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



**MEKA**  
HALAL FOOD

# PASHTETË PULE

gluten  
free



cilësi e garantuar

pa konservues



# BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.




## Irani paralajmëron mundësinë e tërheqjes nga traktati bërthamor

TEHERAN, 28 PRILL - Ministri i Jashtëm iranian, Mohammad Javad Zarif, tha se Teherani mund të tërhiqet nga Traktati për Mospërhapjen e Armëve Bërthamore (NPT) si pjesë e masave hakmarrëse tek shtetet e Bashkuara kanë ashpërsuar sanksionet ndaj Iranit. "Republika Islamike ka një sërë zgjedhjesh dhe autoritetet e shtetit janë duke i shqyrtuar ato dhe largimi nga NPT është një nga to", citohet të ketë thënë Zarif për medien shtetërore iraniane. Komentet e Zarifit vijnë teksa

një gjeneral i rëndësishëm iranian paralajmëroi se Teherani mund ta mbyllë Ngushticën e Hormuzit, që është një rrugë kyçe për kalimin e anijeve, nëse përballet me më shumë "armiçësi". "Ne nuk jemi për mbylljen e Ngushticës së Hormuzit, por nëse armiçësitë e kundërshtarëve tanë rriten, ne jemi në gjendje ta bëjmë një gjë të tillë", tha shefi i stafit të Forcave të Armatosura, Mohammad Bagheri, për agjencinë e lajmeve, ISNA. Uashingtoni ka shtuar presionin politik dhe ekonomik ndaj

Teheranit që prej se presidenti Donald Trump mori detyrën në janar të vitit 2017. Trumpi, në maj të vitit 2018, njoftoi se Uashingtoni tërhiqet nga marrëveshja bërthamore e vitit 2015 dhe do t'i rivendosë sanksionet ekonomike. Irani edhe më herët ka kërcënuar se do të tërhiqet nga Traktati për Mospërhapjen e Armëve Bërthamore dhe vazhdimisht ka thënë se mund të mbyllë Ngushticën e Hormuzit, e cila është një rrugë kyçe ku kalojnë anijet, që transportojnë naftë.



## Zelenskiy refuzon ofertën e Putinit për dhënien e shtetësisë ukrainasve

Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelenskiy, i ka thënë Moskës që të mos humbë kohë duke tentuar t'i joshë qytetarët ukrainas me pasaporta ruse, pasi presidenti rus Vladimir Putin deklaroi se Moska mund ta lehtësojë procesin e marrjes së shtetësisë ruse për të gjithë ukrainasit

KIEV, 28 PRILL - Presidenti i zgjedhur i Ukrainës, Volodymyr Zelenskiy, i ka thënë Moskës "të mos humbë kohë duke tentuar t'i joshë qytetarët ukrainas me pasaporta ruse", pasi presidenti rus, Vladimir Putin, deklaroi se Moska mund ta lehtësojë procesin e marrjes së shtetësisë ruse për të gjithë ukrainasit. Ukrainasit e kuptojnë se shtetësia ruse do të thotë "të drejtën për t'u arrestuar për protesta paqësore" dhe "të drejtën për të mos pasur zgjedhje të lira dhe konkurruese", ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook", presidenti i zgjedhur i Ukrainës, Volodymyr Zelenskiy.

"Është një e drejtë (marrja e shtetësisë ruse), që praktikisht do të thotë që të heqësh dorë nga të gjitha të drejtat dhe liritë", ka shkruar ai. "Dallimi me Ukrainën është në fakt se ne, ukrainasit, kemi lirinë e shprehjes, lirinë e medias dhe internetit", ka shkruar Zelenskiy. Ai, po ashtu, deklaroi se "ukrainasit janë njerëz të lirë që jetojnë në një shtet të lirë", dhe se ata "nuk

duhet të bien pre e gjuhës së kërcënimeve dhe presionit ushtarak dhe ekonomik". Megjithatë, Zelenskiy theksoi se ai është i gatshëm për negociata me Rusinë. Ai u shpreh se "normalizimi real do të ndodhë vetëm pas çlirimit të Donbasit dhe Krimesë".

Moska mori nën kontroll Gadishullin ukrainas të Krimesë më 2014 dhe nxiti trazira në Donbas. Konflikti në lindje të Ukrainës ka lënë të vrarë rreth 13 mijë persona dhe ky konflikt po vazhdon, pavarësisht një marrëveshjeje të armëpushimit dhe të paqes, e njohur si Marrëveshja e Minskut. Rusia mohon përfshirjen në këtë konflikt, pavarësisht se Kievi dhe qeveritë perëndimore thonë se ka prova të pakontestueshme se Moska ka mbështetur me armë, trupa dhe mbështetje tjetër separatistët në këtë rajon.

Presidenti rus Vladimir Putin më 24 prill nënshkroi një dekret, që thjeshtëson procedurat e marrjes së shtetësisë ruse për personat që jetojnë në pjesët lindore të Ukrainës, e që kon-



trollohen nga separatistët që mbështeten nga Moska. Pavarësisht prej kritikave nga Kievi dhe Perëndimi, Putini deklaroi se administrata e tij është duke shqyrtuar një plan, që ta lehtësojë procesin e marrjes së shtetësisë ruse për të gjithë qytetarët ukrainas dhe jo vetëm për ata që jetojnë në lindje të Ukrainës. "Në përgjithësi, ne po mendojmë që t'u japim shtetësinë tonë, në një mënyrë më të thjeshtë, qytetarëve të

Ukrainës", deklaroi Putini teksa po merrte pjesë në një samit në Pekin. Ai nuk e ka uruar Zelenskiy për fitoren e tij në zgjedhjet e mbajtura më 21 prill. Pak kohë pas publikimit të dekretit të Putinit në uebfaqen e Kremlinit, Ministria e Jashtme e Ukrainës e quajti atë "agresion dhe ndërhyrje" në punët e Kievit.

Ambasada Amerikane në Kiev ka shkruar në "Twitter" se dekreti i Putinit është "absurd

dhe destabilizues" dhe riafirmoi edhe një herë "mbështetjen e fuqishme të ShBA-së për sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës".

Më 24 prill, ditën kur u publikua dekreti, Zelenskiy përmes një deklarate dënoi Rusinë, duke e cilësuar si "shtet okupator" dhe "shtet agresor që po bën luftë kundër Ukrainës". Ai bëri thirrje për "rritjen e presionit diplomatik dhe të sanksioneve ndaj Federatës Ruse". (rfe).

## Në Spanjë janë mbajtur zgjedhjet e përgjithshme

MADRID, 28 PRILL - Në Spanjë qytetarët kanë votuar në zgjedhjet e përgjithshme. Njëherësh, këto janë zgjedhjet e treta në katër vjetët e fundit.

Votimet kanë nisur në orën 9:00 sipas kohës lokale dhe kanë përfunduar në orën 20:00. Fushata për zgjedhjet është karakterizuar me rritjen e lëvizjes së të djathtës ekstreme, Vox, e cila kundërshton multikulturalizmin dhe ka kërcënuar se do ta heqë të drejtën e vetëqeverisjes për rajonet, të tilla si

Katalonja.

Kryeministri socialist Pedro Sanchez e ka paraqitur veten si person që kundërshton rritjen e të djathtës ekstreme. Sipas sondazheve, Partia Socialiste e kryeministrit Sanchez do t'i udhëheqë në këto zgjedhje, por nuk do të mund të qeverisë e vetme pa koalicionë, pasi asnjë grup nuk do të mund të fitojë një shumicë në parlament.

Një sondazh i gazetës "El País" thase Partia Socialiste do të fitojë 30 për qind të votave, pasuar nga Partia

Popullore Konservatore me 20 për qind, Ciudadanos e qendrës së djathtë dhe partia e majtë, Podemos, me nga 14 për qind. Ndërkaq, lëvizja Vox, sipas këtij sondazhi, pritet të fitojë rreth 11 për qind të votave.

Një nga çështjet që ka mbizotëruar fushatën zgjedhore është e ardhmja e Katalonjës. Ky rajon gjysm-autonom kishte mbajtur një referendum për pavarësi në tetorin e vitit 2017 dhe kishte shpallur pavarësinë nga Spanja disa javë më vonë.



Dhjetëra liderë të Katalonjës që atëherë janë gjykuar në Madrid dhe

përballen me një sërë akuzash, përfshirë rebelimin dhe kryengritjen.

## "Say My Name" merr 430 milionë klikime, Bebe Rexha falënderon të gjithë



**K**ëngëtarja me prejardhje shqiptare, Bebe Rexha, para pesë muajve e kishte publikuar këngën "Say My Name". Kështu këtë javë kjo këngë ka arritur 430 milionë klikime në

kanalin "Youtube". Këngëtarja ka treguar se është duke festuar për këtë gjë. "Po festoj për këto 430 milionë klikime të 'Say My Name'. Faleminderit të gjithëve!", ka shkruar Bebe Rexha në "Instagram".

## Martohet këngëtarja Jillian Jacqueline



**K**ëngëtarja dhe tekstshkruesja Jillian Jacqueline është martuar dje me kitaristin e grupit të saj Bryan Brown. Ata u martuan në "Ruby" të Nashville, ku patën 150 mysafirë në dasmë. Sipas

"People", në këtë ceremoni kishte më shumë detaje të stilit bohemian që u zgjodh nga çifti. Nusja pati të veshur një fustan të bardhë që i rrinte shumë bukur dhe dhëndri një kostum të zi.



## Gigi Hadidi rikthen farmerkat e viteve të '90-ta

**K**ur është fjala për veshje interesante, pa dyshim se më e njohura e kohës është bërë Gigi Hadid. Kur është fjala për veshje për daljet në mbrëmje, mund të jetë e lehtë ta bësh zgjedhjen: një fustan i zi dhe klasik.

Modeluesja 24-vjeçare po krijon një ide të re sa iu përket veshjeve të mbrëmjeve. Natën e së shtunës, Gigi doli në rrugët e Nju Jorkut me një kombinim të farmerkave të gjera të stilit të nëntëdhjetave dhe një bluzë nga sateni.

## Beyonce dhe Jay-Z darkojnë të rrethuar nga sigurimi



**B**eyonce dhe Jay-Z u panë duke darkuar në Brooklyn ndërsa ishin të rrethuar nga sigurimi. Dëshmitarët thanë se këngëtarja dukej për mrekulli në një kostum të bardhë, duke zbuluar shumë pjesë

nga trupi. Ndërkohë, burri i saj kishte të veshura një palë xhinse dhe një xhup të gjelbër. Sipas "Page Six", çifti kaluan një natë shumë private duke kërcyer dhe u kënaqur për vete.

# BOTA E PËRTEJME E HARUKI MURAKAMIT

Shkrimtari në këtë intervistë flet për stilin dhe procesin e të shkruarit si dhe për vendet e çuditshme e të errëta të cilat i hedh në letër

Intervistoi: Deborah  
TREISMAN

"Si duket ai? A është njeri i këndshëm?" - ishin pyetjet e një udhërrëfyese në ethe, të cilën ma kishin angazhuar për të më prirë nëpër lagjen Aoyama të Tokios, ku ndodhet zyra e Haruki Murakamit. Ndodhej në një ndërtesë diskrete e të pashënuar anash rrugës. Ajo u çlirua kur asistenti i Murakamit e hapi derën, e mori përsipër të merrej me mua dhe e rehatoi që të priste derisa ne ta kryenim drekën e punës në një stacion treni në afërsi. Ishte viti 2010. Në Japoninë e atëhershme Murakami ishte një yll që nuk mund t'i gjendej shoku në botën letrare. Novela e tij e madhe me tri vëllime "1Q84", botuar më 2009 dhe 2010, ishte shitur mbi gjashtë milionë ekzemplarë në Japoni. Kur ai mori pjesë në "Festivalin New Yorker" biletat ishin shitur brenda pak minutash dhe pretendohet se adhuruesit kishin vërshtuar Nju Jorkun nga Japonia, Koreja dhe Australia për ta takuar. Ata kishin bërë gjithë atë rrugë për shkak se Murakami është natyrë ngurruese dhe rrallëherë merr pjesë në ngjarje publike.

Ai tregon se si ishte "befasuar dhe hutuar" prej reagimit së tepërmi entuziast ndaj përpjekjeve të tij të para në fikson. Ai konfuzion mund t'i ketë dhënë shtytje diçkaje brenda tij. Narrativat e tij janë gjithnjë zhbiruese dhe eksploruese. Heronjtë e tij, fatkëqij ose të udhëzuar, i kaktajnë vetes mision eksplorimin. Ngranjëherë mbarojnë në rrethana krejt të zakonshme, nganjëherë krejt të çuditshme. Një stilist subtil dhe njeri krejt i zakonshëm, Murakami është mjeshhtëri i të pasigurtës dhe i sociologjisë. Gjuha e tij është imazh i thjeshtë përshkruar me një mister prapa vetes. Në fiksonin e tij ka shkruar për delen fantome, për

shpirtrat që takohen në botën e përtejme, për njerëzit e vegjël që dalin prej një pikture, por nën imagjinatën ndjellëse, shpesh ëndërrimtare, vepra e tij më shpesh është studim i ndërlikohjeve të munguara, të komedisë dhe të tragjedisë të shkaktuara nga dështimet tona për ta njohur njëri-tjetrin.

*Kjo intervistë është përshtatur me Haruki Murakamin prej bisedave të zhvilluara që i kemi pasur në "New Yorker Festival" më 2008 dhe 2018.*

**Murakami:** Para dhjetë vjetësh kemi zhvilluar intervistën e fundit, dhe shumë gjëra interesante kanë ndodhur gjatë atyre dhjetë vjetëve. Ta zëmë, unë jam dhjetë vjet më plak. Dhe kjo është punë e madhe, së paku për mua. Po plakem përditë dhe, derisa po plakem, po mendoj për veten ndryshe prej kohës së rinisë. Tani në pleqëri po përpiqem të tregohem gjentil dhe romantik. Është si puna e një politikani që mundohet të bëhet Obama dhe Trump. Por kam një përkufizim për një romantik gjentil: së pari, ai nuk flet për shlyerjen e taksave të të hyrave të veta; së dyti, nuk shkruan për ish të dashurata ose ish-gratë; dhe së treti, ai nuk mendon për Çmimin Nobel për Letërsi. Kështu që, Deborah, të lutem, mos më pyet për këto tri gjëra. Do ta kem punën pisk.

*Treisman: Ju porsa ma shteruat depon e pyetjeve. Në fakt, doja të filloja me librin tuaj më të fundit, novelën tuaj të re, "Killing Commendatore". Vepra bën fjalë për një burrë të cilin e lë gruaja. Ai përfundon në shtëpinë e një artisti plak, një piktori. Kur të mbërrijë në atë shtëpi, nisin të ndodhin shumë gjëra të çuditshme, dhe disa prej tyre duket se dalin prej një vrime në tokë - njëfarë bunari pa ujë. Po hamendem si ju erdhi kjo premisë për novel-*

*ën.*

**Murakami:** Është një libër voluminoz, ju e dini, dhe më ka marrë një vit e gjysmë kohë, ose aty diku, për ta shkruar, por nisi me vetëm një ose dy paragrafë. I shkrova ata paragrafë dhe i lashë në tavolinën e punës dhe nuk u mora me ta. Pastaj, nja tre ose gjashtë muaj më vonë, më erdhi ideja se mund t'i ktheja ata, një ose dy paragrafë, në një novelë, dhe nisa ta shkruaja. Nuk kisha kurrfarë planesh, nuk kisha kurrfarë orari. Nuk kisha linjë rrëfimi: Thjesht, nisa prej atij paragrafi, ose atyre dy paragrafëve dhe vazhdova të shkruaja. Dhe rrëfimi vetë më priu deri në fund. Nëse keni ndonjë plan - nëse e dini fundin kur të filloni - nuk ndieni kurrfarë qejfi ta shkruani atë novelë. E dini, piktori mund të bëjë skica para se ta nisë pikturimin, por jo edhe unë. Gjithçka është e bardhë, unë kam brushën në dorë dhe, thjesht, pikturoj.

**Treisman:** Ka një karakter, ose një ide në novelë që formëson "Commendatoren" nga opera e Mozartit, "Don Giovanni". Pse pikërisht kjo ide, ky karakter, në bosh të librit?

**Murakami:** Zakonisht, i filloj librat me pak. Në këtë rast kisha titullin "Killing Commendatore" dhe kisha paragrafët e parë të librit dhe po hamendesha se çfarë lloj rrëfimi mund të shkruaja me ta. Nuk ka diçka si puna e "Commendatores" në Japoni, por ndieja atë të çuditshmen e titullit dhe çmoja shumë të çuditshmen.

**Treisman:** A është e rëndësishme për ju opera "Don Giovanni"?

**Murakami:** Shumë i rëndësishëm për mua është karakteri. Përgjithësisht, nuk i përdor modellet. Në karrierën time kam përdorur një model për një karakter vetëm një herë. Ai ishte një djalë i dalë dore, asi që nuk më pëlqente hiç, dhe doja të shkruaja për të,

por vetëm një herë. Krejt karakteret e tjera në veprat e mia i kam bërë prej hiçit, nga zeroja. Kur e sajoj një karakter, ai a ajo lëviz automatikisht dhe, krejt çfarë më duhet të bëj, është ta shikoj derisa sillet vërdallë dhe flet e kryen punë. Jam shkrimtar dhe po shkruaj, por njëherësh ndiej sikur të isha duke lexuar një libër mahnitës dhe interesant. Prandaj, shkrihem kur shkruaj.

**Treisman:** Karakteri kryesor në libër dëgjon operën, por edhe pjesë të ndryshme muzikore që i përmendni në libër. Shpesh karakteret tuaja dëgjojnë grupe ose zhanre të ndryshme muzikore. A ju ndihmon kjo që ta shtjelloni atë çfarë përfaqësojnë?

**Murakami:** Dëgjoj muzikë derisa shkruaj. Kështu që muzika natyrisht vjen në shkrimin tim. Nuk lodhem fort se çfarë lloj muzike është por, për mua, muzika është një lloj ushqimi. Më jep energji të shkruaj. Andaj, shkruaj shpesh për muzikën, më së shumti shkruaj për muzikën që e dua. Është e mirë për shëndetin tim.

**Treisman:** Po thoni se muzika jua ruan shëndetin?

**Murakami:** Po, shumë bile. Muzika dhe macja. Ato më ndihmojnë goxha shumë.

**Treisman:** Sa mace i keni?

**Murakami:** Asnjë. Dal të vrapoj mëngjesve rreth shtëpisë dhe rregullisht i shoh tri ose katër mace. Janë shoqe të mia. Ndalem


dhe u them 'tung' dhe ato më afrohen; e njohim njëri-tjetrin fort mirë.

**Treisman:** Kur "The New Yorker" botoi pjesë të "Killing Commendatore", ju pyeta për elementet joreale në veprën tuaj. Ju thatë: "Kur shkruaj novela, realja dhe jorealja thjesht shkrihen bashkë. Nuk është se kam ndonjë plan dhe unë po e ndjek me përpikëri, por sa më shumë që provoj të shkruaj për realitetin në mënyrë reale, aq më joreale pashmangshëm më shfaqet bota. Për mua, novela është si puna e një ndeje. Kushdo që dëshiron të bashkëngjitet, është i mirëseardhur dhe, ata që duan të largohen, mund ta bëjnë kur t'ua dojë qejfi". Andaj, si i ftoni njerëzit dhe gjërat në këtë ndeje? Ose si arrini në një vend kur jeni duke shkruar ku mund të vijnë edhe si të pafuar?

**Murakami:** Lexuesit shpesh më thonë se ka një botë joreale në krijimtarinë time - se protagonistit shkon në atë botë dhe pastaj kthehet përsëri në botën reale. Por nuk është se unë mund ta shoh gjithnjë vijën kufitare ndërmjet botës joreale dhe botës reale. Prandaj, në shumë raste, ato botë përzihen e shkrihen. Në Japoni mendoj se bota tjetër është shumë afër jetës sonë reale dhe, nëse vendosim të shkojmë përtej, nuk është punë e zorshme. Kam përshtypjen se në botën perëndimore nuk është e lehtë të shkosh përtej kësaj bote; duhet të kaloni nëpër disa gjykime për të kaluar në botën tjetër. Andaj, në tregimet







e mia, nëse lëshoheni deri në fund të bunarit, ka një tjetër botë. Dhe nuk është e domosdoshme ta tregoni ndryshimin ndërmjet kësaj ane dhe anës tjetër.

**Treisman:** Ana tjetër, zakonisht, është një vend i errët?

**Murakami:** Jo domosdoshmërisht. Mendoj se më shumë lidhet me kureshtjen. Nëse ka një derë dhe ju mund ta hapni dhe të hyni në atë vend, hapeni. Është thjesht kureshtje. Çfarë ka brenda? Çfarë ka aty? Pra, këtë punë bëj përditë. Kur jam duke shkruar novelë, zgjohem diku në katër të mëngjesit dhe ulem para tavolinës së punës dhe nis të shkruaj. Kjo ndodh në një botë reale. Gjerb kafe të vërtetë. Por, kur nis të shkruaj, humbem diku tjetër. Hap derën, futem dhe shoh çfarë po ndodh atje. Nuk e di - ose nuk dua t'ia di - nëse ka një botë reale ose një joreale. Lëshohem thellë e më thellë derisa përqendrohem me krejt qenien në shkrim, në njëfarë nëntoke. Derisa jam atje, merrem me gjëra të çuditshme. Por derisa po i shoh, me sytë e mi, duken krejt natyrale. Dhe nëse aty ka errësirë, ajo errësirë më del para syve dhe, mbase, ka ndonjë mesazh, e dini? Po përpiqem ta kap mesazhin. Prandaj, shoh atë botë dhe përshkruaj çfarë shoh, pastaj kthehem përsëri. Kthimi në botën reale është i rëndësishëm. Nëse nuk mund të kthehesh, është e frikshme. Por, unë jam profesionist, prandaj mund të kthehem.

**Treisman:** Dhe me vete i keni edhe ato gjëra?

**Murakami:** Jo, do të ishte e frikshme. Gjithçka e lë në vendin e vet. Kur nuk jam duke shkruar, jam njeri krejt i rëndomtë. Respektoj rutinën e përditshme. Zgjohemi herët në mëngjes. Shtrihem në nëntë të mbrëmjes, nëse nuk ka ndonjë ndeshje bejsbollit. Dhe vrapoj ose notoj. Jam njeri i rëndomtë. Kështu që kur dal në rrugë dhe dikush më thotë: "Më falni, zoti Murakami, më vjen mirë që ju takova", më duket e çuditshme, e dini. Nuk kam asgjë të veçantë. Pse qenka ai i lumtur pse më takoi mua? Por mendoj se kur jam duke shkruar jam disi i veçantë - ose i çuditshëm, e pakta që mund të them.

**Treisman:** E keni treguar disa herë historinë se si dyzetë vjet më parë në një ndeshje bejsbolli papritmas ju ra ndërmend: 'Unë mund të shkruaj'. Megjithëse as kishit provuar më parë të shkruarit. Dhe në kujtimet tuaja, "What I Talk About When I Talk About Running", keni thënë: "Sikur diçka piku nga qielli dhe e kapa me duart e mia". Pra, piku aftësia për të shkruar ose, mbase, vetëm ideja se ju mund të provonit. Nga mendoni se erdhi, dhe pse ju erdhi, nëse jeni kaq i rëndomtë?

**Murakami:** Njëfarë pagëzimi, kurrëgjë më shumë. E dua bejsbollin dhe shpesh dal në parkun e lojërave. Më 1978, kur isha 29 vjeç, shkova në parkun e bejsbollit në Tokio për ta parë ekipin tim të

preferuar, Yakult Swallows. Ishte ditë e hapur, ditë me diell. Po shikoja ndeshjen dhe lojtari i parë me shkop shënoi dyshifror. Në atë çast ndjeva se mund të shkruaja. Mbase kisha pirë shumë birra, nuk e di, por në atë çast sikur përjetova njëfarë pagëzimi. Para atij çasti nuk kisha shkruar kurrëgjë. Isha pronar i një klubi jazz dhe isha shumë i zënë duke bërë koktej dhe sandviçë. Gatuaj sandviçë të shijshëm! Por, pas ndeshjes, shkova në librari dhe mora disa gjëra, pastaj nisa të shkruaja dhe u bëra shkrimtar.

**Treisman:** Po flisni për dyzetë vjet më parë. Sa jua ndryshoi të shkruarit jetën?

**Murakami:** Kam ndryshuar shumë. Kur nisa të shkruaja nuk dija si të shkruaja. Shkruaja në mënyrë shumë të çuditshme, por njerëzve u pëlqente. Tani nuk lodhem fort për librin tim të parë, "Hear Wing Sing"; ishte shumë herët që ta botoja. Shumë vjet më parë isha ulur në tren në Tokio, duke lexuar një libër, dhe erdhi një vajzë shumë e bukur tek unë dhe më tha: "A jeni ju zoti Murakami?" "Po, unë jam zoti Murakami". "Jam adhuruese e madhe e veprave tuaja". "Faleminderit shumë!" "Dhe i kam lexuar të gjitha veprat tuaja dhe i dua". "Faleminderit! E çmoj këtë". Pastaj ajo tha: "Më së shumti më pëlqen vepra juaj e parë. Ajo është më e mira, mendoj unë". "Oh, kështu mendoni?" Dhe ajo tha: "Keni nisur ta lëshoni dorën me

kalimin e kohës". Kështu që u mësova me kritikant. Por, nuk pajtohem. Mendoj se po ia marr dorën më mirë. Për dyzetë vjet me radhë jam orvatur për më mirë dhe mendoj se ia kam dalë mbanë.

Ajo vajzë në tren më bën të mendoj për një muzikant jazz, emri i të cilit ishte Gene Quill. Ai luante në saksofon dhe ishte i famshëm gjatë viteve gjashtëdhjetë dhe shtatëdhjetë. Dhe, sikurse cilido saksofonist i asaj kohe, ishte ndikuar shumë prej Charlie Parkerit. Një natë po luante në një klub jazz në Nju Jork dhe derisa po largohej nga skena, iu afrua një riosh dhe i tha: "Hej, krejt çfarë po bëni është po i bini si Charlie Parkeri". Gene tha: "Çka?" "Krejt çfarë po bëni është po i bini si Charlie Parkeri", i përsëriti ai. Gene e hoqi saksofonin, instrumentin ia dha djaloshtit dhe i tha: "Hajde ti bjeri si Charlie Parkeri!" Mendoj se kjo anekdotë i ka mesazhet: e para, është e lehtë ta kritikosh dikë; e dyta, është shumë e vështirë të krijosh diçka origjinale; e treta, po dikush duhet ta bëjë. E kam bërë për dyzetë vjet me radhë. Është detyrë imja. Mendoj se jam një burrë që po bën çfarë duhet të bëjë, si puna e pastrimit të kanaleve ose mbledhja e taksave. Prandaj, nëse dikush tregohet i sertë me mua, do ta heq instrumentin dhe do t'i them: "Merre, bjeri!"

**Treisman:** Thatë se shkrimi i dy librave të para ishte punë shumë e lehtë, pastaj nisi të bëhej paksa më e vështirë. Ku ju has sharra në gozhdë?

**Murakami:** Kur i shkrova ata dy libra, "Hear the Wind Sing" dhe "Pinball, 1973", më dukej e lehtë të shkruaja, por nuk isha i kënaqur me librat. Ende nuk jam i kënaqur me to. Pasi i krevata ata dy libra nisa të bëhesha më ambicioz. Shkrova "A Wild Sheep Chase" - novelën time të parë të gjatë. (Dy të tjerat ishin më shumë novela të shkurtra). Ajo mori kohë tri ose katër vjet, ma ha mendja, dhe përnjëmend u desh të gërmoja thellë për ta gjetur burimin. Kështu që mendoj se "A Wild Sheep Chase" ishte pikë fillestare e karrierës sime të vërtetë. Gjatë tre vjetëve të para po shkruaja derisa po punoja si pronar i klubit të jazzit. E mbaroja punën në dy të mëngjesit, pastaj uleshja të shkruaja në tavolinën e bukës në kuzhinë. Kjo ishte ngarkesë tepër e madhe. Pas dy librave të para, vendosa ta shisja klubin dhe të bëhesha tamam shkrimtar. Por klubi i jazzit po shkonte mirë dhe të gjithë më këshilluan të mos e shisja.

**Treisman:** Mos e lë punën e ditës!  
**Murakami:** Pastaj shkrova "A Wild Sheep Chase". Doja të shkruaja një libër voluminoz.

**Treisman:** Dhe a ishte më e lehtë të shkruaje libra më të mëdhenj, ose a ishte më shumë punë sfiide?  
**Murakami:** Kur e shkrova "A Wild Sheep Chase" u mahnita shumë sepse nuk e dija çfarë do të ndodhte pastaj. Mezi prisja të vinte e

nesërmja që ta merrja vesh çfarë më priste. Doja ta ndërroja faqen, por nuk kishte asnjë faqe. Duhej t'i shkruaja.

**Treisman:** A ndodh ndonjë ditë të mos keni ide se çfarë ju pret? Uleni dhe nuk mund ta hidhni asnjë fjalë në letër?

**Murakami:** E kam përjetuar bllokimin sikur çdo shkrimtar. Kur ulem pranë tavolinës së punës, natyrisht e di se çfarë do të pasojë. Nëse nuk e di, ose nëse nuk dua të shkruaj diçka, nuk shkruaj. Revistat gjithnjë më kërkojnë t'u shkruaj diçka dhe gjithnjë u them jo. Shkruaj kur dua të shkruaj, çfarë dua të shkruaj, qysh mua ma do qejfi të shkruaj.

**Treisman:** A mendoni se temat i shtjelloni në gjumë?

**Murakami:** Jo, nuk ma merr mendja. Nuk ëndërroj. Rrëfimet janë rrëfime, ëndra ëndërr. Dhe, për mua, vetë të shkruarit është si puna e ëndërrimit. Kur shkruaj mund të ëndërroj qysh unë dua. Mund të filloj, mund të ndalem dhe mund të vazhdoj të nesërmen, qysh ta vendos unë. Kur je në gjumë dhe sheh ëndërr të bukur, me një copë të shijshme mishi ose me një birrë të shijshme, ose me ndonjë vajzë të bukur, dhe kur zgjoheni, gjithçka merr fund. Por unë mund të vazhdoj të nesërmen.

**Treisman:** Para disa vjetësh më keni thënë se derisa po merreshit me një novelë mbanit një listë idesh ose frazash, si "një majmun që flet", ose "një burrë që zhduket shkallëve", dhe se kur mbaruat veprën dhe u ulët të shkruanit rrëfime, thatë: "Secili rrëfim duhet të ketë dy ose tri gjëra nga kjo listë". A funksionon shpesh kjo metodë?

**Murakami:** Ka ndodhur kur i shkrova gjashtë rrëfime përnjëherësh. Prandaj kish ato fjalë aty për të më ndihmuar. Në novelë nuk më duhen. Rregull e kam që të provoj gjithnjë diçka të re. Shumicën e veprave të para i kam shkruar në vetën e parë. Në "1Q84" shkrova karaktere në vetën e tretë. Kjo ishte për mua sfiduese. Në shumicën e herëve, narratori im, protagonistimi im, është një djalë që mund të isha unë, por që ai nuk jam unë. Njëfarë alternative e vetes, e dini? Në jetë jam vetvetja dhe nuk mund të jem tjetër, por në fikcion mund të jem kushdo. Mund t'i mbath këpucët e tjetërkujt. Mund ta quani njëfarë terapie. Nëse mund të shkruanit, nuk fiksoheni. Mund të jeni kushdo qoftë, e keni këtë mundësi.

**Treisman:** Keni filluar të vraponi në të njëjtën kohë kur nisët të shkruanit. Njoh disa njerëz që iu pëlqen të shkruajnë në mendje derisa ecin; ritmi i ecjes i ndihmon. A mendoni për të shkruarit derisa vraponi?

**Murakami:** Jo, aspak. Kur vrapoj, vrapoj me tërë qenien. Mendjen e kam bosh. Nuk kam ide se çfarë po mendoj derisa vrapoj. Mbase

Vijon në faqën 18



E jashtëzakonshme

# Gjendet diamanti i dytë më i madh në botë

Në një minierë në Bostvana është gjetur diamanti i dytë më i madh i regjistruar në histori. Sipas një njoftimi të kompanisë së diamanteve me qendër në Kanada, Lucara, diamanti i papërpunuar prej 1.758 karatësh është gjetur në Minierën Karowe. Ekspertët kanë nisur



punimet për përcaktimin e vlerës dhe cilësisë së diamantit, i cili është më i madhi në historinë e shtetit afrikan dhe i dyti në historinë botërore. Diamanti ka madhësinë e një topi të tenisit dhe peshon 352 gramë.

## BARSOLETA E DITËS



Derisa po patrullonin dy policë, njëri i thotë tjetrit:  
- A po shkon në furrë ta blesh një byrek se kam uri?  
Ky tjetri shkon në furrë e kur kthehet i thotë:  
- Nëse e di sa byrekë kam blerë, do të t'i jap që të dy.



## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

### “HOW TO TRAIN YOUR DRAGON; The Hidden World” 3D

I Animuar/Aksion Aventure; 1 ore 44 min

Rolet: Jay Baruchel, America Ferrera, Cate Blanchett, Kit Harrington, Craig Ferguson, F. Murray Abraham, etj.  
Regjia: Dean DeBlois



FOTO E DITES



Mbetjet e plastikës shihen duke lundruar në një kanal kanalizimesh në kryeqytetin e Haitit Port-au-Prince. /AFP/

Në ora 18:00 (gjate vikendit ne ora 14:00 dhe 18:00)

### “THE KID WHO WOULD BE KING”,

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 ore 50 min

Rolet: Louis Ashbourne Serkis, Dean Chaumoo, Tom Taylor, Rhianna Dorris, Angus Imrie, Rebecca Ferguson, Patrick Stewart, etj.

Regjia: Joe Cornish



Në ora 20:00

### “CAPTAIN MARVEL” 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 ore 08 min

Rolet: Brie Larson, Samuel L. Jackson, Ben Mendelsohn, Djimon Hounsou, Lee Pace, Gemma Chan, Annette Bening, Jude Law, etj.

Regjia: Anna Boden, Ryan Fleck




Në ora 22:00

### “U S”

Horror/Triller; 1 ore 56 min

Rolet: Lupita Nyong'o, Winston Duke, Elisabeth Moss, Tim Heidecker, Yahya Abdul-Mateen II, Anna Diop, Evan Alex, Shahadi Wright Joseph, Madison Curry, Cali Sheldon, Noelle Sheldon

Regjia: Academy Award@-winning visionary Jordan Peele



E rrallë

# Gruaja në shtëpi frikësohet për vdekje, i trokiti aligatori rreth dy metra në derë

Një grua nga Florida u detyrua të përballlet me një mik të paftuar në shtëpi. Ajo u trondit kur pa se në derën e saj ishte një aligatori rreth 2.5 metra i gjatë. Donna Heiss, 58-vjeçare, nuk e



kishte idenë se si zvarraniku u gjend para shtëpisë së saj atë ditë. Pak minuta pasi hyri brenda, aligatori e tmerroi për vdekje sepse ishte agresiv dhe godiste pa pushim derën.

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).

 <p><b>DASHI</b> Keni lajme të bukura që doni t'i ndani me të gjithë. Do të gjeni disponibilitetin e personave që ju duan dhe ju mbështesin.</p>	 <p><b>DEMI</b> Këtë ditë doni të merrni përgjegjësi të reja mbi vete. Planet tuaja do i konsultoni me partnerin.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Sot do t'ju shoqërojnë gjatë ditës tuaj persona të gëzueshëm dhe mjaft të vendosur.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Instikti juaj ju çon drejt një drejtimi që nuk ishte destinacioni juaj parësor. Gjithsesi është më i miri.</p>	 <p><b>LUANI</b> Sot mjafton të ndani mirë oraret e ditës dhe çdo gjë do t'ju shkojë siç dëshironi. Partneri ka një kërkesë për ju.</p>	 <p><b>VIRGJERESHA</b> Objektivat e ditës suaj përqendrohen vetëm tek puna. Mos harroni që dhe familja ka të njëjtën rëndësi.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Ditën e sotme duhet të gjeni aleate të fuqishëm për të mbrojtur një projekt që ka kundërshtitë e veta.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Nëse doni të merrni në dorë fatin tuaj sot mundohuni të qartësoni disa situata të dyshimta.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Në ditët e shkuara keni bërë një gabim që do t'ju duhet pak kohë për ta rikuperuar. Gjithsesi do të dini si të veproni.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Sot një çështje financiare do t'ju shkaktojë shumë stres. Nëse ju kap paniku nuk do të arrini të zgjidhni gjë.</p>	 <p><b>UJORI</b> Nëse keni mundësi për të mbaruar punë sot mos e neglizhoni. Koha nuk ju premtonte për të gjitha projektet tuaja.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Sot do të bëni zgjedhje që shkojnë ndesh me ato që vendosni zakonisht. Do të rezultojnë mjaft produktivë.</p>

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE  
**"BUJQËSIA"**

TEL: 045 82 82 82

# Garuesit nga Kenia triumfojnë në gjysmëmaratonën 'Prishtina 2019'



Garuesit nga Kenia kanë dominuar në të dyja konkurrencat në gjysmëmaratonën 'Prishtina 2019' në disiplinën 21 kilometra, e cila është mbajtur të dielën. Pjesëmarrës në këtë gjysmëmaratonë ishte edhe kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, i cili ka paralajmëruar ndryshime për edicionin e 20. "Është e mundur të bëhen edhe disa përmirësime në organizim, që të jemi edhe ne në hap me trendët globalë, duke bërë ndryshime në rrugë dhe mos të dërgohen më sportistët kah Obiliqi për shkak të tymit", ka thënë kryeministri Haradinaj

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 28 PRILL - Garuesit nga Kenia kanë dominuar edhe në gjysmëmaratonën 'Prishtina 2019' në disiplinën 21 kilometra. Edicioni i 19 i gjysmëmaratonës është organizuar nga Federata e Atletikës së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Komuna e Prishtinës. I pari doli Hoseat Kiplagat Tuei, kurse i dyti Kipruto Kibire. Vendi i tretë i ka takuar Yoseef Sbaai. Edhe në kategorinë e femrave ishte atletja nga Kenia, Ruth Chemisto Matebo, ajo e cila zuri vendin e parë. Edhe dy vendet e tjera iu kanë takuar garueseve nga Kenia, Euliter Jepchipchir dhe nga Ruth Nundu Mbatha. "Gara ishte shumë e mirë, shumë e fortë. Unë e shijova. Unë vazhdimisht stërvitem dhe gjithmonë jam i pranishëm në

atletikë", ka thënë Hoseat Kiplagat Tuei.

Nga garuesit vendorë triumfues doli Tiron Mamusha, ndërsa në garën 5 kilometra fitues doli Çlirim Hyseni nga Trepça '89, kurse i dyti doli Gent Kaja. Te femrat e para doli Gresa Bakraqi, e cila është shpallur atletja më e mirë e vitit nga Federata Atletike e Kosovës.

Në këtë gjysmëmaratonë, si zakonisht, pjesëmarrës ishte edhe kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj. Pas përfundimit të shtegut 21 kilometra, kryeministri Haradinaj ka përgëzuar të gjithë pjesëmarrësit në këtë garë, kurse ka bërë me dije se në gjysmëmaratonën e ardhshme shtegu i saj mund të ndryshojë për shkak të tymit të Obiliqit. "I përgëzoj të gjithë garuesit, prej më të rinjve e deri të më të vjetrit, pjesëtarët e policisë, ekipet mjekësore, ushtarët

e FSK-së, të cilët u kujdesen për mbarëvajtjen e kësaj ngjarjeje, që ka qenë e mrekullueshme. Është e mundur të bëhen edhe disa përmirësime në organizim, që të jemi edhe ne në hap me trendët globalë, duke bërë ndryshime në rrugë dhe mos të dërgohen më sportistët kah Obiliqi për shkak të tymit", ka thënë kryeministri Haradinaj. Sikurse kryeministri Haradinaj, edhe Federata e Atletikës ka paralajmëruar se nga edicioni i ardhshëm pritet të bëhen ndryshime të mëdha, përfshirë edhe rritjen e shtegut nga 21 në 41 kilometra. Pas përfundimit të gjysmëmaratonës janë ndarë çmime për të gjitha kategoritë e vrapuesve në këtë garë. Gjysmëmaratona e Prishtinës është gara me e madhe sportive ndërkombëtare që zhvillohet dhe promovon Kosovën në arenën ndërkombëtare përmes sportit.

## SHKURT

## Prishtina, kampione në ligën e femrave në basketboll

Vashat e Prishtinës kanë fituar ndaj Bashkimit në ndeshjen e pestë në serinë finale me rezultat 71-76 dhe janë shpallur kampione të Kosovës. Finalja e femrave ka qenë shumë interesante me Prishtinën dhe Bashkimin që kanë dhuruar spektakël në secilin takim. Seria e finaleve ka qenë e barabartë me të dyja klubet që kanë fituar nga dy ndeshja dhe fituesi është përcaktuar në ndeshjen e pestë. Ishin vajzat nga kryeqyteti të cilat arritën ta fitojnë takimin e pestë me rezultat 71-76 në palestrën e mbushur "Sezai Surroi" në Prizren.

## U17 realizoi fitoren e dytë në Letoni

Përfaqësuesja e Kosovës U17 ka shënuar fitore edhe në ndeshjen e dytë në kuadër të turneut zhvillimor të UEFA-s që po mbahet në Letoni. Pas fitores kundër Andorrës (1-0), futbollistët e drejtuar nga Besnik Kollari në ndeshjen e dytë kanë arritur ta mposhtin ekipin organizator të këtij turneu, Letoninë, pas penalltive me rezultat 4-2. Koha e rregullt u mbyll 1-1. Kosova U17 do ta mbyllë garën në këtë turne më 30 prill me ndeshjen kundër San Marinos, ekip të cilin Letonia e mundi në ndeshjen e parë me shifrat 7-0.

## Seminar për gjyqtarët e gjimnastikës

Federata e Gjimnastikës e Kosovës në bashkëpunim me Unionin Evropian të Gjimnastikës organizon seminarin e dytë për gjyqtarë, kësaj radhe nga gjimnastika artistike për meshkuj. Seminari filloi të dielën dhe përfundon më 1 maj. Ligjërues janë ekspertët nga UEG: James May (Britani) dhe Mario Vukoja (Kroaci).

## Kosova U16 e nis me fitore turneun në Estoni

Përfaqësuesja e Kosovës U16 në konkurrencën e femrave e ka nisur me fitore turneun zhvillimor të UEFA-s në Estoni. Vashat e drejtuara nga trajneri Kushtrim Munishi në ndeshjen e parë në kuadër të këtij turneu e kanë mposhtur Letoninë me rezultat 2-0. Kosova pati paraqitje shumë të mirë dhe e mbizotëroi plotësisht lojën. Golin e parë e shënoi Njomza Osmani në minutën e 40, kurse epërsinë e shtoi Fortesa Berisha në minutën e 50. "Kemi dominuar plotësisht ndaj kundërshtarit. Vajzat i kryen me përpikëri detyrat e dhëna. Kemi krijuar edhe shumë raste të tjera shënimi dhe tani duhet të punojmë më shumë për finalizimin e aksioneve. Shpresoj të kemi paraqitje të tilla edhe në dy ndeshjet e ardhshme", ka thënë trajneri Kushtrim Munishi. Ndeshjen e dytë Kosova e luan kundër Estonisë më 30 prill, kurse përballjen e fundit e luan kundër Lihtenshtajnit më 2 maj.

## S'ka fitues në 'Old Trafford', Unitedi larg Ligës së Kampionëve

Manchester, 28 prill - Manchester United nuk ia ka dalë të mposhtë në "Old Trafford" skuadrën e Chelsea, pasi rezultati final mbeti 1-1. Juan Mata

zhbllokoj sfidën duke ndëshkuar ish-ekipin e tij në minutën e 9-të, por Chelsea barazoi shifrat me anë të Alonsos, i cili shfrytëzoi një gafë për portierit David De

Gea. Fraksioni i dytë i lojës foli më shumë për Chelsea, por rezultati mbeti i pandryshuar. Teksa në lojë janë vetëm 6 pikë, Unitedi e gjen veten në vendin e gjashtë, tre pikë larg

dhe një pikë larg Arsenalit. Një fitore e bluve të Londrës do të mbyllë matematikisht shanset e "djajve të kuq" për të arritur zonën e Ligës së Kampionëve.



## Mundja fiton dy norma për Lojërat Evropiane 'Minsk 2019'

PRISHTINË, 28 PRILL - Komitetit Olimpik të Kosovës i janë konfirmuar dy norma kualifikuese për sportin e mundjes për pjesëmarrje në Lojërat e dyta Evropiane "Minsk 2019" të cilat mbahen prej 21-30 qershorit të këtij viti në kryeqytetin e Bjellorusisë. Mundja normat i ka fituar në kate-

goritë deri në 57 kilogramë dhe deri në 125 kilogramë. Fitimi i normave për Federatën e Mundjes së Kosovës vjen pas paraqitjeve të mundësve Drilon Sylja (-57 kg) dhe Egzon Shala (-125 kg) në Kampionatin Evropian të mbajtur në fillim të këtij muaji në Bukuresht të Rumanisë.

Evropiani ishte kualifikues edhe për Lojërat Evropiane "Minsk 2019". Shala kishte shënuar një fitore, ndërsa Sylës i kishte mjaftuar humbja me rezultat të ngushtë në raundin e parë, e cila ia ka mundësuar fitimin e normës kualifikuese për në "Minsk 2019". Pikërisht Sylja e Shala

do ta përfaqësojnë mundjen e Kosovës në Minsk. Me dy normat e mundjes, numri i sportistëve që do ta përfaqësojnë Kosovën në Lojërat e dyta Evropiane Minsk 2019 shkon në 11. Pesë norma janë nga xhudoja, kurse nga një ftesë është për boksën, karatenë, pingpongun dhe shigjetarin.



## Trepça '89 'fundosi' Lirinë



PRISHTINË, 28 PRILL - Skuadra e Trepçës '89 e ka fundosur edhe më shumë Lirinë (2-1) dhe në këtë mënyrë ia ka vështirësuar gjastat për mbetjen në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Pas njëmbëdhjetë minutave lojë, Orges Gava kaloi vendësit në epërsi 1-0, por pesë minuta para fundit të pjesës së parë Blendi Memaj e barazoi rezultatin në 1-1. Në minutën e 62-të Arb Manaj e vulosi rezultatin final 2-1. Pas kësaj ndeshje '89-shi renditet në pozitën e pestë me 39 pikë, kurse Liria mbetet e parafundit me 25 pikë.

Skuadra lidere e Superligës, Feronikeli, ka shënuar fitore para tifozëve të vet në duel me Gjilani (2-0). Kastriot Rexha e zhbllkoi shifrën në minutën e tetë, kurse fitoren e skuadrës nga Drenasi e

vulosi braziliani Carioca në minutën e 35-të me golin e shënuar nga penalltia. Fitore në shtëpi ka realizuar edhe Llapi në duel me Dritën, por shumë më të vështirë sesa Feronikeli. Në fakt, tri pikë të rëndësishme në garën për titull llapjanëve ua siguroi Festim Alidema, me një eurogol në minutën e 71-të, që njëherësh ishte goli i vetëm i këtij takimi. Ndërkaq, Ferizaj ka shënuar fitore tepër të rëndësishme në Suharekë në duel me Ballkanin, me rezultat 4-2, duke iu shmangur zonës së barazhit pas kësaj jave. Dren Gashi (30', 48'), Qëndrim Dautaj dhe Ermal Krasniqi (90+3') shënuan për fitoren e skuadrës së Bylbyl Sokolit, kurse për nikoqirët realizuan Jetmir Topalli (40') dhe Bajram Nebihu (90+5').

IPKO SUPERLIGA		
Llapi - Drita		1-0
Feronikeli - Gjilani	2-0	
Ballkani - Ferizaj		2-4
Trepça '89 Liria	2-1	
Prishtina-Drenica		
Flamurtari-KEK-u		
TABELA		
		PIKË
1. Feronikeli	29	68
2. Llapi	29	66
3. Prishtina	28	65
4. Drita	29	47
5. Trepça '89	29	39
6. Drenica	28	38
7. Gjilani	29	35
8. Ferizaj	29	34
9. Ballkani	29	33
10. Flamurtari	28	32
11. Liria	29	25
12. KEK-u	28	1
LIGA E PARË		
Dukagjini - Istogu		2-1
Onix - Trepça		1-2
Arbëria - Vllaznia		1-0
Vëllaznimi - Vitia		1-1
2. Korriku - Vushtrria		4-0
Ramiz Sadiku - Besa		2-1
Drenasi - Bashkimi (K)		0-1
Fushë Kosova - Kika		2-0
TABELA		
		PIKË
1. Vushtrria	26	60
2. Dukagjini	26	53
3. Besa	26	52
4. Vëllaznimi	26	48
5. Vitia	26	44
6. Onix	26	37
7. Trepça	26	34
8. Arbëria	26	33
9. 2 Korriku	26	32
10. Drenasi	26	29
11. Istogu	26	29
12. Fushë Kosova	26	28
13. Ramiz Sadiku	26	27
14. Kika	26	26
15. Bashkimi (K)	26	26
16. Vllaznia	26	24

## Denveri kualifikohet në gjysmëfinale

DENVER, 28 PRILL - Denveri është ekipi i katërt gjysmëfinalist në Konferencën e Perëndimit pas fitores 90-86 që arriti ndaj San Antonios në sfidën e shtatë çerekfinale mes tyre. Një përballje shumë e fortë kjo mes dy ekipeve, që deri në fund luajtën për fitore (Denver fitoi 4-3 serinë). Skuadra e Denverit e meritoi fitoren, duke qenë gjatë gjithë ndeshjes në epërsi, duke u shkëputur deri në 17 pikë (Murray 23 pikë). Një ndeshje e mirë e Jokiçit, që realizoi një "triple double" për Denverin, 21 pikë, 15 rebounde e 10 asistime, raporton "Telesport". Në Lindje kanë nisur ndeshjet gjysmëfinale, ku Toronto fitoi 108-95 ndaj Philadelphia në sfidën e parë. Ndeshje e dominuar nga skuadra kanadeze, që u shkëput deri në 20 pikë, duke mos e vënë në diskutim fitoren. Leonardo ishte magjik në këtë sfidë, duke realizuar 45 pikë e 11 rebounde, mbështetur edhe nga Siakam me 29 pikë.

### KONFERENCA E PERËNDIMIT - ÇEREKFINALE "PLAY-OFF"

1-8 Golden State - Clippers		(4-2)
4-5 Houston - Utah Jazz		(4-1)
3-6 Portland - Oklahoma		(4-1)
2-7 Denver - San Antonio	90-86	(4-3)

### KONFERENCA E LINDJES - GJYSMËFINALE "PLAY-OFF"

Milwaukee - Boston		
Toronto - Philadelphia	108-95	(1-0)

### Konferenca e Perëndimit - Gjysmëfinale "play-off"

Golden State - Houston		
Portland - Denver		

## SHKURT

### Bottas triumfoi në Azerbajxhan

Mercedesi ka arritur një tjetër fitore të dyfishtë në këtë sezon të Formulës 1. Valtteri Bottas fitoi duke dominuar nga fillimi në fund Çmimit të Madh të Azerbajxhanit, duke lënë pas shokun e tij të skuadrës, Lewis Hamilton. Kjo është fitorja e katërt e dyfishtë e Mercedesit në katër garat e para të Botërorit, një rekord me vete ky. Ndërkohë, tjetër garë e zbehtë e Ferrarit, që arriti vetëm një vend të tretë me Sebastian Vettelin dhe një vend të pestë me Charles Leclerc. Pas kësaj gare, në renditjen e përgjithshme të pilotëve tashmë është kryesues Bottas, duke kaluar në klasifikim Hamiltonin.

### Nadali eliminohet nga turneu i Barcelonës

Pas dështimit në Montekarlo një javë më parë, tenisti spanjoll Rafael Nadal ka marrë një tjetër goditje, këtë herë në turneun ATP 500 të Barcelonës. Numri 2 në botë u mund 2-0 në gjysmëfinale nga Dominic Thiem (6-4, 6-4). Duket se fushat me dhe nuk janë më një "aleat" për Nadalin, sipërfaqja e tij e preferuar, pasi spanjoli ka dorëzuar dy tituj të fituar vjet. Ndaj austriakut Thiem tenisti spanjoll humbi nga një "game" me shërbimet e tij, duke u eliminuar në gjysmëfinale. Nadali nuk ka fituar ende asnjë turne këtë vit, ndërsa Thiem siguron kualifikimin për në finale, ku do të luajë ndaj rusit Daniil Medvedev. Ky i fundit, në ndeshjen tjetër gjysmëfinale, mundi 2-1 (6-4, 3-6, 7-5) japonezin Kei Nishikori.

### Lyoni 'lakmon' Wengerin për postin e trajnerit

PSG-ja është pa dyshim ekipi që po dominon tërësisht në Francë prej vitesh, me Lyonin që ndoshta ka qenë ekipi që është mundur më së shumti për t'i prishur punë vitet e fundit. Edhe sezonin e ardhshëm pritet që Lyoni ta bëjë të njëjtën gjë teksa pritet të ketë shumë ndryshime, duke nisur që nga bankina. Trajneri aktual Bruno Zhenesio ka deklaruar se do të largohet në fundin e sezonit. I gjendur përpara këtij fakti, presidenti i francezëve ka nisur kërkimet për një trajner të ri dhe Lyoni e ka një ëndërr. Është pikërisht Arsen Wenger i cili ka drejtuar për herë të fundit një ekip francez plot 25 vjet më parë, kur ishte në krye të Monacos. Presidenti Zhan-Mishel Olas do të mundohet ta bindë ish-teknikun e Arsenalit, me një operacion që duket i vështirë, por jo i pamundur.

### Unitedi do t'i shesë Pogban dhe Lukakun

Manchester Unitedi ka vendosur t'i shesë dy prej yjeve kryesorë të skuadrës Paul Pogban dhe Romelu Lukakun, raporton "Mirror". Real Madridi mbetet favoriti për ta transferuar Pogban, edhe pse është përfolur për një kthim të tij të mundshëm në Juventus. Ndërkohë Juventus ka shprehur, po ashtu, interesim edhe për Lukakun. Unitedi synon t'i inkasojë rreth 230 milionë euro nga këta dy futbollistë, në përpjekje për ta rindërtuar skuadrën për sezonin e ardhshëm.

### Chiellini: Juve tregoi se është skuadra më e fortë në Itali

Giorgio Chiellini u rikthye të luajë pas një muaji mungesë për Juventusin, me kapitenin që në fund të ndeshjes me Interin nuk ngurron që t'i thumbojë zikaltrit, duke u nisur nga paraqitja e bërë në pjesën e dytë nga skuadra e tij. "E vërteta është që duhet ta largojmë nga trupi mendimin se si mund të kishin shkuar ndryshe gjërat, pasi kjo është mënyra e vetme për të zbritur në fushë i përqendruar. Ne jemi me fat që kemi mundësi të luajmë këto ndeshje të mëdha, edhe kur gjithçka është mbyllur, por pas një pjese të parë të luajtur pa shumë qejf, në të dytën u zgjuam dhe vendosëm të luajmë siç dimë të bëjmë ne. Doli në pah Juventus i vërtetë, që e vrau kampionatin, por edhe ndaj Interit tregoi se cila ishte skuadra më e fortë. Vetë Interi e kuptoi se kush është më i forti në Itali gjatë pjesës së dytë, kur e patëm mundësinë që edhe ta përmbysnim ndeshjen", ka thënë Chiellini. "Çfarë i thamë njëri-tjetrit në dhomat e zveshjes? Asgjë të veçantë, thjesht që të fillojmë të luajmë siç dimë ne. Ronaldo? Me Cristianon e nis gjithmonë ndeshjen me 1-0. Është një jashtëtokësor dhe do të na ndihmojë që të fitojmë ende shumë në të ardhmen", ka deklaruar ai.



		<b>Autor: GAZMEND MORINA</b>		KËNGËTARJA NË FOTO	METAFORË E GJATË	SHOSHIT	THIRRJE E MYEZINIT	QENGJ I BUTË	I EDITON	LLOJ KAFEJE	<b>EPOKA E RE</b>	DRYNI	ZANORE	NJË E RESHUR
	LLOJ LULEJE										HATA, MJERIM I MADH BASHKËT.			
	KËNGËTARJA SHQIPTARE MARKU												ZANORE FJALË E RËNDË DHE E PAHIJSHME	
	SHARRËZ; SËMUNDJE SHUMË E RËNDË										RAST SAKSI			
	FILLIM I AGIMIT					NATRIUM, TON ISH FUTBOLLISTI ALTIN				SHTËPIA LUKSOZE PËR PUSHIME FUTBOLLIST LEGJENDAR BRAZILIAN				
	SHPREHU ME FJALË						KËNGËTARJA ..... RADI KËNGËTARJA GJERMANE .... KONOR (shqip.)							SFOND SHKRONJASH
	NËPËR ARA, ARAVE							REKRUTI NË PERANDORINË OSMANE LLOJ BIME QË PËRDORET SI ERËZ PËR GJELLË						
	KTHINË NË SHTËPI KU RUHEN USHQIMET								PJESË E FORTË E BUKËS (sh.shq.) PJESËMARRJE NË NJË GARË					
<b>EPOKA E RE</b>	ENË E MADHE PREJ METALI QË SHËRBEU PËR TË ZIER UJË	TRADITA	KLUB FUTBOLLI NË FRANCË (shqip.)	LLOJ KROKODILI	CILËSI E NJË SENDI A E NJË DUKURIE	ZANORE EVERTON	TRAJNERI ITALIAN ..... SAKI APO				AKTORJA E VJETËR ... RINA LLOJ REVOLEJE			
KËNGËTARJA JONË SAMANTA							TITULL OTOMAN FUSHËBETEJË (sh.shq.)				BASHKËT. ENDE		KOHË E NDARË PËR PUNË (sh.pashq.)	BASHKËT. "O" më mes të dy "R"
KËNGËTARE E NJOHUR ANGLEZE						REGJISORI ... QOSJA I PËRZJEVE, I TRAZOVE		GOJËTARI STUDIM ME KARAKTER KRITIK OSE PUBLICISTIK						
PIKA MË E LARTË NË KUPËN E QIELLIT							LUMË NË KOSOVË AFRICAN METHODIST EPISCOPAL				ZHANËR I MUZIKËS EMËR MASHKULLI MYSLIMAN (shq.)			
ANITA TAKE			BALTË E QULLËT (shq.) RRJETA E TENISIT				EDITA SOP-JANI ALBERTO TOMBA			MOTAK ISH FUTBOLLISTI ITALIAN MAX ..... (ROMA)				KËNGËTARJA E FAMSHME ... KIM
HIT NGA GRUPI MUZIKOR "NRG BAND"					POROSI E FUNDIT PARA VDEKJES SIGURIM I GJËRAVE TË NEVOJSHME PËR JETESË					MARYLAND ASSOCIATION REALTORS SHTET NË AMERIKËN JUGORE			BASHKËT. GRADË OFICERË MADHOR E SHKALLËS SË PARË	
<b>EPOKA E RE</b>	THEMELUESI I TURQISË MODERNE MUSTAFA ..... ATATURK	PUSULLA NISESHTJA						FUTBOLLISTI NIGERIAN MARTINS (LEVANTE) INDONEZIA, XHAMAJKA						
ELEKTRODA E POLIT NEGATIV NË NJË BURIM RRYME						GYP NË TRUPIN E NJERIUT NËPËR TË CILËT KALON GJAKU (shq.)	FUTBOLLISTI ... COSTA (VALENCIA) KËNGËTARJA ANGLEZE TANITA				ZANORE KAMPIONI, ASI (Sport)		ALUMIN ARMENIA	
PRINCIPATË ARABE (sh.shq.)								AKTORI YNË NIK FËMIJË I VOGËL						INTERESI BANKAR NGA KREDIA
NOTË MUZIKORE			QESËNDISËS, SATIRIK PASURIA E PATUNDSHME QË SILLTE TË ARDHURA						LLOJ, SOJI PRONË E VOGËL E SPAHINJVE FEUDALË OTOMAN				OLIVER KAHN PIKTORI ... VALLA	
SHOUMENI ... KRASTA				E GJYMTOVA KIK-BOKSIERI MAKSUTAJ								FRYMA EMËR YNI MASHKULLI		
KËNGËTARE DHE MODERATORE E JONA					EMPOLI ZANORE		LETRARI ASLLANI DY BASHKËTINGËLLORE		REGJISORJA SHQIPTARE ... ELEZI ARIZONA					MOLDE GOTË PREJ METALI
<b>EPOKA E RE</b>	KAJDE, OJNA PATRIK KLAIVERT					GJINI E LETËRSISË ARTISTIKE DY BASHKËTINGËLLORE				I PESHOVA (bised.) NYJË				
GATESË E JONA TRADICIONALE					GRIPI APOLONIA				ZANORE ISLANDA		SHTET (FR.) ANDORA			
KRUJA		KRYEHOXHË					DETAR						NË ÇFARË MASE	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë  
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry  
Departamenti i Industrisë

### FTESË PUBLIKE

Njoftohen të gjitha palët e interesuara (Trupat për Vlerësimin e Konformitetit) se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Departamenti i Industrisë, kërkon të emëroj:

1. Trupa për vlerësimin e konformitetit për vlerësimin e konformitetit të cilësisë së karburanteve të lëngëta të naftës,
2. Në zbatim të Ligjit Nr.06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit, Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 12/2018 për Mënyrën e Emërimit të Trupave për Vlerësimin e Konformitetit,
3. Në zbatim të Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr.01/2017 për Cilësinë e Karburanteve të Lëngëta të Naftës,
4. Trupa për vlerësimin e konformitetit në zbatim të legjislationit në fuqi duhet të jenë të akredituara në fushën për të cilën kërkojnë emërim, në përputhje me kërkesat e standardit SK EN ISO/IEC 17025 apo SK EN ISO/IEC 17020 për produktet e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ Nr.01/2017 për Cilësinë e Karburanteve të Lëngëta të Naftës,
5. Trupat për vlerësimin e konformitetit të cilat aplikojnë për emërim duhet të bashkëngjisin në aplikacion të gjitha dokumentet e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ Nr. 12/2018 për Mënyrën e Emërimit të Trupave për Vlerësimin e Konformitetit,
6. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjitet lista me çmimet për shërbimet e vlerësimin të konformitetit për karburantet e lëngëta të naftës,
7. Ltesa publike është e hapur 15 dite punë pas ditës së publikimit,

Aktet e lartcekura mund t'i gjeni në ueb-faqe të MTT-së dhe Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës:

Në bazë të Vendimit të Dt.29.10.2018, Nr.Prot.1955, fatura për aplikim për emërim merret në Departamentin e Industrisë, zyra Nr.120, ndërsaq dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohet në Arkivin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Për çdo paqartësi, Trupat për vlerësimin e konformitetit që aplikojnë për emërim në kompetencën e fushës së lartcekur, mund të vijnë paraprakisht të konsultohen në Departamentin e Industrisë rreth kompletimit të dosjes para se lënda të dorëzohet në arkiv të MTT-së.

Adresa:  
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë  
Departamenti i Industrisë  
Tel. i zyrës : 038 200 36 545

Adresa: Lagjia e Spitalit Rr.Muharrem Fejza pn 10.000 Prishtinë-Kosovë Tel:038 512 138  
<http://www.mti-rks.org>

## Njoftim

Njoftojmë të interesuarit se me datën 15 Maj 2019 (E Mërkurë) me fillim në orën 12:00 Bsc. i dipl. Florim Zejnullahu mbron punimin e Masterit me titull "Efekti i mekanizimit të përdorur dhe llojit të hibridit në rendimentin e kokrrës së misrit". Mbrojtja publike do të jetë në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë në Prishtinë.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë  
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry  
Departamenti i Industrisë

### JAVNI POZIV

Obaveštavaju se zainteresovane strane (Tela za Ocenjivanje Usaglašenosti) da Ministarstvo Trgovine i Industrije – Odeljenje za Industriju, zahteva da imenuje:

1. Tela za Ocenjivanje Usaglašenosti za ocenjivanje usaglašenosti kvaliteta tehničkih goriva,
2. U primeni Zakona br. 04/L-039 o Tehničkim Zahtevima za Proizvode i Ocenjivanje Usaglašenosti, Administrativnog Uputstva br. 04/2016 o Načinu Imenovanja Tela za Ocenjivanje Usaglašenosti,
3. U primeni Administrativnog Uputstva Br. 07/2012 o Kvalitetu Tehničkih Naftnih Goriva,
4. Tela za Ocenjivanje Usaglašenosti u skladu sa važećim zakonodavstvom treba da budu akreditovani u oblasti za koju zahtevaju imenovanje, u skladu sa zahtevima SK EN ISO/IEC 17025 Standarda ili SK EN ISO/IEC 17020 za proizvode navedene u Administrativnom Uputstvu br. 01/2017 o Kvalitetu Tehničkih Naftnih Goriva.
5. Tela za Ocenjivanje Usaglašenosti koja apliciraju za imenovanje moraju aplikaciji priložiti sva dokumenta navedena u Administrativnom Uputstvu br.04/2016 o Načinu Imenovanja Tela za Ocenjivanje Usaglašenosti.
6. Aplikaciji treba da se priloži lista cena za usluge ocenjivanja usaglašenosti za tečna naftna goriva,
7. Javni poziv je otvoren 15 radnih dana od dana objavljivanja,

Gore navedeni akti mogu se naći na internet stranici MTT-a i Službenom Listu Republike Kosovo.

Na osnovu Odluke datuma 29.10.2018, Br. Prot. 1955, račun za aplikaciju za imenovanje uzima se u Odeljenju Industrije, ured br. 120, dok kompletirana dokumentacija se dostavlja u Arhivu Ministarstva Trgovine i Industrije.

Za bilo koje pitanje, Tela za Ocenjivanje Usaglašenosti koja apliciraju za imenovanje u okviru nadležnosti navedenog područja, mogu doći prethodno na konsultacije u Odeljenju Industrije o popunjavanju dosijea pre nego što se predmet dostavi u arhivu MTT-a.

Adresa:  
Ministarstvo Trgovine i Industrije  
Odeljenje za Industriju  
Tel. kancelarije: 038 200 36 545

Adresa:LagjiaSpitaliRr.MuharremFejzavn 10.000 Prishtinë-Kosovë Tel:038 512 138  
<http://www.mti-rks.org>

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Mirzo Dana shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHF "Dy Dëshmorët" Priranë.

► Blerim Maliqi shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Ebru Gorda shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX SHF "Motrat Qiriazit" Prizren.

► Burcu Kaan shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX SHF "Emin Duraku" Prizren.

► Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.

► Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irro 044/672-439.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Shes banesën hyrja e 7 mbi kurriz te banesat e gjelbërta përball shkollës "Xhemajl Mustafa" e rinovuar tërësisht. Banesa ka 82 metra katror. 3 dhoma, sallon, shpajz dhe ballkon + taras me shfrytëzim. Çmimi 75000 Euro me para te gatshme, por bej edhe ndërrim me banesë me të vogël në Prishtinë ose banesë më të madhe në Fushë Kosovë sipas marrëveshjes. Numri kontaktues: 044 672 439

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.


► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.


► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.


► Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

**TOP  
PAKO**

 Komunikim **FALAS**

 Internet deri në **50Mbps**

 Televizion Digjital

*Për vetëm 17euro*

## TOP PAKO, PËR TË GJITHË!

TOP Pakot përmbajnë të gjitha shërbimet e nevojshme të komunikimit për biznese të vogla por edhe për familje.

Prej vetëm 17.00€, **10 numra me komunikim FALAS**, PLUS:

- ∞ minuta drejt IPKO-së;
- ∞ SMS;
- Internet në mobil deri në 5GB;
- Televizion digjital dhe Internet deri në **50Mbps**;
- Telefoni Fikse me tarifa standarde;

Për më shumë informata, vizitoni dyqanin më të afërt të IPKO-së.

[WWW.IPKO.COM](http://WWW.IPKO.COM)

